



Agjencia për Mbështetjen
e Shqërisë Civile

RAPORT I ZGJERUAR VJETOR

2018

RAPORT I ZGJERUAR **VJETOR** **2018**



RAPORT MBI VEPRIMTARINË E AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE GJATË VITIT 2018

Tiranë, Maj 2019

Tabela e përmbajtjes:

KAPITULLI I

- *Vështrim i përgjithshëm*2

KAPITULLI II

- *Ecuria e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë ndër-sektoriale kundër korrupsionit 2015-2020*5
- *Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" si dhe i Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"*6
- *Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 11 sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale*8
- *Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese*10

KAPITULLI III

- *Monitorim vlerësimi i treguesve buxhetorë për vitin 2018*15
- *Plani i Buxhetit Viti 2018*15
- *Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2018*16
- *Ecuria e disbursimeve të granteve financiare*18

KAPITULLI IV

- *Aktivitetet kryesore të AMSHC-së për vitin 2018*23

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, është një ent publik, buxhetor krijuar me Ligjin me nr. 10093 datë 09.03.2009 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.

AMSHC-ja është krijuar me qëllimin për të asistuar me Mbështetje Financiare dhe Teknike Shoqërinë Civile në vend duke qenë e përkushtuar të promovojë, mbështesë dhe mbrojë parimet e dinjitetit njerëzor, lirisë, barazisë, mos-diskriminimit, sundimit të ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut, transparencës dhe profesionalizmit.

Një shoqëri civile aktive, e fuqishme dhe gjithë përfshirëse mund të luajë një rol të rëndësishëm për zbatimin në praktikë të këtyre parimeve. Ajo është gjithashtu një komponent thelbësor i çdo demokracie funksionale.

Duke artikuluar shqetësimet e qytetarëve, organizatat e shoqërisë civile, si subjekte jo-shtetërore, struktura jo-fitimprurëse, në të cilat njerëzit organizohen të ndjekin objektivat dhe idealet e përbashkëta, duhet të jenë gjithnjë e më shumë aktive për çështje publike si dhe të angazhohen në iniciativa që nxisin pluralizmin dhe pjesëmarrjen në demokraci.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në kuadër të politikës së fuqizimit të shoqërisë civile, është përqendruar në stimulimin e demokracisë pjesëmarrëse dhe gjithë përfshirëse.

Kjo reflektohet në përpjekjet për krijimin e një mjedisi që është i favorshëm për aktivitetet e shoqërisë civile dhe ndërtimin e kapaciteteve të OJF-ve për të qenë aktorë të efektshëm, të përgjegjshëm dhe të pavarur, nëpërmjet formalizmit të procedurave transparente dhe jo-diskriminuese të regjistrimit, veprimtarisë

së lirë dhe të pavarur, si dhe bashkëpunimit midis qytetarëve etj.

Shoqëria civile, duke pasur struktura të përshtatshme dhe mekanizma për bashkëpunim me AMSHC-në dhe institucionet e tjera publike, si dhe fluks të lirë, të qartë dhe të arritshme të informacionit mbi çështjet e interesit publik përmes mekanizmave të qëndrueshme dhe të strukturuar, rrit autonominë e saj, atë të përfaqësimit dhe të llogaridhënies, duke forcuar bazën e organizatave sipas standardeve më të larta të qeverisjes së brendshme, nëpërmjet përfshirjes së strukturave demokratike, monitorimit dhe vlerësimit, menaxhimit financiar, transparencës, informimit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.

Organet dhe funksionet e institucionit

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile është krijuar me Ligjin nr. 10093 datë 09.03.2009 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile*” dhe ka si mision të saj, nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për përmbushjen e këtij misioni, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si detyrë të saj funksionale që të ofrojë asistencë financiare dhe teknike për programet që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse; bashkëpunimin ndër-sektorial e ndërkombëtar; nismat civile; filantropi; vullnetarizmin e institucioneve demokratike të shoqërisë civile; si dhe programe të tjera, që lehtësojë përmbushjen e misionit të saj.

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- *nxitjen e bashkëpunimi me OJF-të, që kanë objekt të punës mbikëqyrjen e luftës kundër korrupsionit; luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore e të trajtimit të viktimave të saj; kundër dhunës në familje e kundër dhunës ndaj fëmijëve;*
- *nxitjen e qytetarëve në veprimtari, përfshirja e pjesëmarrja e tyre për zhvillimin e komunitetit;*
- *respektimin e të drejtave të njeriut;*
- *krijimin e konsolidimin e kapaciteteve të shoqërisë civile;*
- *zhvillimin e bashkëpunimit ndër sektorial dhe e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të shoqërisë civile;*
- *rritjen e ndikimit publik dhe veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile në vendimmarrje;*
- *zhvillimin e sipërmarrjes shoqërore dhe punësimit në sektorin jofitimprurës;*
- *rritjen e ndikimit të shoqërisë civile në proceset e hartimit dhe të miratimit të politikave publike*
- *përcaktimin e procedurave të zbatueshme për shpërndarjen e fondeve në mbështetje të shoqërisë civile etj.*

Kuadri ligjor, organizimi strukturor dhe funksionimi i AMShC-së

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile funksionon dhe mbështet punën e saj duke u bazuar në një paketë të plotë ligjore, si vijon:

- a) Ligji me nr. 10093 datë 09.03.2009 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile*”. Ky ligj, deri më sot nuk ka pësuar asnjë ndryshim.
- b) Vendimi nr. 769 datë 15.07.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- c) Vendimi nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- d) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 20.09.2010.
- e) Rregullorja e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e azhurnuar në përputhje dhe përshtatje me ndryshimet e parashikuara në Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile””. Këto ndryshime janë miratuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 30.11.2011.
- f) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile” të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës me Vendimin nr. 1 datë 08.07.2010.
- g) Rregullorja “Mbi procedurat e Financimit me Grante në Mbështetje të Shoqërisë Civile”, e ndryshuar me vendimin e Bordit Mbikëqyrës në mbledhjen e datës 10.03.2011.
- h) Vendimi nr. 1 datë 08.07.2010 i Bordit Mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, nëpërmjet të cilit janë miratuar:
 - Formati i Aplikimit.
 - Kriteret e Vlerësimit.
 - Kontrata Tip
- i) Udhëzimin nr. 1 datë 29.12.2010 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për plotësimin e raporteve financiare dhe kontrollin financiar, për efekt të monitorimit të Projekteve të financuara me Grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”.
- j) Urdhri nr. 161 datë 05.09.2013 i Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile “Për procedurën e administrimit të akteve shkresore, kërkesave/projekt-propozimeve, formimin e dosjeve dhe mënyra e qarkullimit të tyre në AMSHC”.

KAPITULLI II

Ecuria e zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë ndër-sektoriale kundër korrupsionit 2015-2020

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile ka zbatuar e raportuar masat e parashikuara në plan si më poshtë:

Në kuadër të monitorimit të strategjisë ndër-sektoriale kundër korrupsionit 2015-2020, në vijim të monitorimit të kësaj strategjie, në thirrjen e saj të 11-të, një nga prioritetet e përcaktuara ishte Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korrupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale dhe qëndrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;

Në tabelën Nr. 1 të mëposhtme gjendet në mënyrë të detajuar tabela e shpërndarjes së projekteve fituese të thirrjes dhjetë në kuadër të zbatimit të strategjisë ndër-sektoriale kundër korrupsionit 2015-2020. Shuma totale e disbursuar nën këtë fushë prioritare krahas fushave të tjera prioritare është: **16,700,000 lekë.**

Fushat Prioritare:

- 1. Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korrupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale dhe qëndrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;*

Tabela 1

Emri i OJF-së	Titulli i Projektit	Shuma e Akorduar (në Lekë)
Instituti i Bashkëpunimit Rajonal për Integrim (IBRI)	Qytetari aktive në qeverisjen e bashkisë Krujë	2,500,000
Qendra për Ndhimë Rehabilitim dhe Integrim (QNRI)	Nxitja e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale	2,500,000
Albanian Mobile Technology	Përmirësimi i raportimit mediatik në Shqipëri për publikun ndërkombëtar	3,300,000
Qendra për Qeverisje të Mirë	Koalicioni Qytetar për Mjedisin (KQM) strukturë partnere për një mjedis më të mirë në nivel vendor në Bashkinë Kuçovë	4,000,000
Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza	Praktikat gjithëpërfshirëse dhe aksesit i viktimave të dhunës ndaj sistemit të drejtësisë. Mbështetja e Linjës Kombëtare për viktimat e dhunës në familje	2,000,000
Qendra ALTRI (Instituti i Studimeve Ligjore dhe Territoriale)	Lufta kundër korrupsionit fillon nga studentët e drejtësisë që zgjedhin integritetin!	2,400,000
Totali		16,700,000

Zbatimi i Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" si dhe i Ligjit "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik"

A. Hartimi i Programeve të Transparencës sipas ligjit të ri për të drejtën e informimit

Realizuar nga AMSHC:

ZBATIMI I LIGJIT "Për të Drejtën e Informimit". Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur programi i transparencës për Agjencinë e Mbështetjes së Shoqërisë Civile. Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" (LDI).

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës AMSHC ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së. Autoriteti Publik do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së. Informacioni i bërë publik synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së AMSHC-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare **www.amshc.gov.al** si dhe në mjediset e pritjes së publikut.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentin. Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet.

Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë. Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje.

Faqja zyrtare e AMSHC-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve të të dhënave, etj.

Në lidhje Thirrjen e radhës, AMSHC krijoi mundësinë e një Pyetësoni online me qëllim mbledhjen e sugjerimeve mbi prioritetet nga shoqëria civile.

B. Zbatimi i plotë i ligjit për konsultimin publik

Në kuadër të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” me objekt si më poshtë vijon:

- 1. Ky ligj rregullon procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik të projektligjeve, projektdokumenteve strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.*
- 2. Ky ligj përcakton rregullat procedurale që duhen zbatuar për të garantuar transparencën dhe pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike.*
- 3. Ky ligj synon nxitjen e transparencës, të përgjegjshmërisë dhe integritetit të autoriteteve publike.*

AMSHC-ja ka marre masat e nevojshme për zbatimin e këtij ligji për të gjithë veprimtarinë e AMSHC-së, duke e kthyer procesin e konsultimit publik për çështje dhe vendime të caktuara si element kyç dhe thelbësor të strategjisë së punës së saj.

AMSHC-ja në vijim praktikës së punës së saj si dhe të Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” dhe në zbatim të Ligjit të saj Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” e në zbatim të rekomandimeve afatshkurtra të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) ka ndërmarrë rishikimin e dokumentit të Udhërrëfyesit për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile (miratuar me VKM nr.459, datë 27.5.2015).

Për këtë qëllim, AMShC organizoi katër takime konsultative me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), përkatësisht në Vlorë 10 korrik, Korçë 12 korrik, Shkodër 17 korrik dhe Tiranë 20 korrik 2018.

Ndërkaq në vijim praktikës së punës së saj si dhe zbatimit të Ligjit nr. 146/2014 “Për

Njoftimin dhe Konsultimin Publik” AMSHC-ja organizoi takime me aktorë të shoqërisë civile për Prezantimin, Informimin dhe Konsultimin mbi Programin Anti-Korrupsion të AMShC-së; në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC).

Takimet e informimit dhe konsultimit me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile u organizuan në disa qytete të vendit *Peshkopi; Korçë; Pogradec; Vlorë ; Përmet; Kukës; Berat; Tiranë*

Në zbatim të Ligjit "Për të Drejtën e Informimit" dhe Programit të Transparencës, Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile publikoi në faqen e saj zyrtare www.amshc.gov.al dhe në disa gazeta kryesore në vend, shpalljen e Thirrjes Nr. 11 dhe të gjitha modalitetet juridiko-financiare përkatëse.

Në mënyrë të vazhdueshme AMSHC-ja bën publike në faqen e saj të internetit si dhe në rrjetet sociale aktivitetet e ndryshme në kuadër të monitorimit të projekteve nën Thirrjen Nr. 11 për projekt propozime.

Analiza dhe statistika të shpërndarjes së granteve të Thirrjes 11 sipas fushave prioritarë si dhe shtrirjes territoriale

Fushat prioritarë - Thirrje Nr. 11 të për projekt-propozime:

1. *Kujdesi ndaj mjedisit dhe ambientit, duke promovuar nisma ndërgjegjësuëse dhe aksione të tjera në drejtimin e mirëmbajtjes ambientale dhe territoriale dhe prioritetet e tjera;*
2. *Fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile;*
3. *Mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (jetimët, personat me aftësi të kufizuar, minoritete, LGBTI, etj) nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare;*
4. *Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale dhe qëndrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;*
5. *Turizmi dhe kultura, si një binom zhvillimi për territorin e Shqipërisë, nëpërmjet iniciativave që kanë si qëllim rritjen e përdorimit të resurseve turistike dhe kulturore, të ndërthurura me protagonizmin rinor dhe atë të shoqërisë civile*

Statistikisht shpërndarja e projekteve nën secilin prioritet strategjik paraqitet sipas Tabelës nr. 2.

Tabela 2

Nr.	Fushat Prioritare	Nr. Projekteve	Shuma e financuar për secilin prioritet (në lekë)	Pesha Specifike (në %)
1	Kujdesi ndaj mjedisit dhe ambientit, duke promovuar nisma ndërgjegjësuëse dhe aksione të tjera në drejtimin e mirëmbajtjes ambientale dhe territoriale dhe prioritetet e tjera:	13	30,300,000	28.1
2	Fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile;	2	3,800,000	3.5
3	Mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (jetimët, personat me aftësi të kufizuar, minoritete, LGBTI, etj) nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare;	4	6,700,000	6.2

4	Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale dhe qendrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;	4	10,700,000	9.9
5	Turizmi dhe kultura, si një binom zhvillimi për territorin e Shqipërisë, nëpërmjet iniciativave që kanë si qëllim rritjen e përdorimit të resurseve turistike dhe kulturore, të ndërthurura me protagonizmin rinor dhe atë të shoqërisë civile	6	15,600,000	14.5
6	Më shumë se një fushë	16	40,600,000	37.7
Total		45	107,700,000	100%


Siç mund të verëhet nga tabela prioriteti me përqindjen me të lartë të projekteve të zbatuara është ai nën kategorinë “Kujdesi ndaj mjedisit dhe ambientit, duke promovuar nisma ndërgjegjëse dhe aksione të tjera në drejtimin e mirëmbajtjes ambientale dhe territoriale dhe prioritetet e tjera me 28.1 % që do të thotë që nën këtë prioritet projektet implementuese dhe vetë OJF-të i kanë venë theksin mjedisit, një tregues i rëndësishëm për aktualitetin dhe shoqërinë shqiptare.

Ndërkaq sqarojmë se kategoria më shumë se një fushë është një kategori që gjithnjë ka një përqindje të lartë pasi projektet prekin më shumë se një fushë prioritare.

Përqindjen më të ulët të mbulimit me projektet e zë Fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile me 3.5 %.


Grafiku 1

Paraqitja grafike e të dhënave të Tabelës nr. 1



Grafiku 2

Paraqitja grafike e peshës specifike të projekteve të financuara për secilën fushë prioritare



Shpërndarja territoriale sipas qarqeve administrative e projekteve fituese Thirrja Nr. 11

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në mënyrë të vazhueshme duke qenë se në filozofinë e saj e misionin e saj ka një shpërndarje të projekteve fituese sa më të gjerë në të gjithë territorin. Në të njëjtën përjasje edhe në thirrjen e saj Nr. 11 të drejtuar OJF-ve për shprehje interesi për Projekt Propozime e ka pasur si objektiv kryesor një shpërndarje territoriale sa më të gjerë në nivel kombëtar.

Tabela 3

Nr.	Shtrirja e projekteve në Nivel Qarku	Nr. i projekteve Fituese
1	Qarku Berat	4
2	Qarku Dibër	1
3	Qarku Durrës	5
4	Qarku Elbasan	3
5	Qarku Fier	2
6	Qarku Gjirokastrë	5
7	Qarku i Korcë	5
8	Qarku Kukës	2
9	Qarku Lezhë	3
10	Qarku Shkodër	5
11	Qarku Tiranë	19
12	Qarku Vlorë	6
13	Projekte në Nivel Kombëtar	5

Nga ana grafike të dhënat e Tabelës nr. 3 lidhur me shpërndarjen territoriale sipas qarqeve administrative do të pasqyroheshin sipas Grafikut nr. 3.

Grafiku 3




Tabela 4


Shpërndarja Territoriale e projekteve për Thirrjen 11 sipas qyteteve

Nr.	Shtirja e projekteve sipas qyteteve	Nr. i projekteve Thirrja Nr.11
1	QARKU BERAT	4
1.1	Berat	4
1.2	Kucovë	0
1.3	Skrapar	0
2	QARKU DIBËR	1
2.1	Peshkopi	1
2.2	Bulqizë	0
2.3	Mat	
2.4	Klos	0
3	QARKU DURRËS	5
3.1	Durrës	5
3.2	Krujë	0
4	QARKU ELBASAN	2
4.1	Elbasan	2
4.2	Gramsh	0
4.3	Librazhd	0
4.4	Peqin	0
5	QARKU FIER	2
5.1	Fier	1
5.2	Lushnje	1
5.3	Mallakastër	0
5.4	Roskovec	0
6	QARKU GJIROKASTËR	5
6.1	Gjirokastrë	3
6.2	Përmet	1
6.3	Tepelene	1
7	QARKU KORÇË	5
7.1	Korçë	3
7.2	Devoll	1
7.3	Pogradec	1

7.4	Kolonje	0
7.5	Maliq	0
7.6	Pustec	0
8	QARKU KUKËS	2
8.1	Kukës	1
8.2	Tropojë	1
8.3	Has	0
9	QARKU LEZHË	3
9.1	Lezhë	2
9.2	Kurbin	0
9.3	Mirditë	0
10	QARKU SHKODËR	5
10.1	Shkodër	2
10.2	Puke	1
10.3	Malësi e Madhe	0
10.4	Vau i Dejës	1
10.5	Fush-Arrëz	0
11	QARKU TIRANË	19
11.1	Tiranë	13
11.2	Kamëz	1
11.2	Kavajë	3
11.4	Vore	2
12	QARKU VLORË	6
12.1	Vlore	4
12.2	Sarandë	1
12.2	Delvine	1
12.4	Selenice	0
12.5	Himarë	0
12.6	Finiq	0
12.7	Konispol	0

Grafikisht Shpërndarja Territoriale e Projekteve Fituese të Thirrjes 11 sipas Qyteteve shprehet:

Grafiku 4



Siç mund të vihet re nga të dhënat e mësipërme të tabelës si dhe nga grafiku, projektet fituese kanë një përqëndrim më të lartë të zbatueshmërisë në rrethin e Tiranës.

Mbulimi për financim me projekte në përgjithësi prek të gjitha qarqet administrative. Mbulimin me përqindje më të lartë siç u përmend dhe më lartë e zë Qarku i Tiranës, më pas vijne qarqet Berat; Vlorë; Gjirokastrë Elbasan, Durrës, Korçë etj.

KAPITULLI III

Raporti i Monitorimit

Hyrje

Në mbështetje të nenit 104 pika 4 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 65 të Ligjit Nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” (të ndryshuar), Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 “Për Buxhetin e Vitit 2018”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ju paraqesim Raportin e Monitorimit të Zbatimit të Buxhetit për Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile për Vitin 2018.

Monitorim vlerësimi i treguesve buxhetorë për vitin 2018

Monitorimi është një proces vlerësimi performance i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë të performancës me ato të planifikuara. Pra, monitorimi është procesi që lidh realizimin e objektivave dhe produkteve me fondet përkatëse të planifikuara për arritjen e tyre.

Me anë të këtij relacioni/raporti monitorimi të Buxhetit të AMSHC-së për Vitin 2018, Ju detajojmë informacionin mbi efektivitetin e përdorimit të fondeve buxhetore dhe performancën e produkteve të realizuara për Vitin 2018 përsa i përket Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Në përdorimin e fondeve buxhetore, AMSHC-ja është mbështetur në parimet e menaxhimit dhe mirëfunksionimit të sistemit buxhetor. Shpërndarja e burimeve financiare është bërë në përputhje me politikat ekonomike dhe prioritetet e AMSHC-së, duke pasur si synim një përdorim sa më eficient të këtyre burimeve, përgjegjësi të qarta për menaxhimin e shpenzimeve për çdo produkt, në funksion të realizimit të objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara për vitin 2018.

Plani i Buxhetit Viti 2018

Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, në mbështetje të Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 “Për Buxhetin e Vitit 2018”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, është akorduar fond prej **123 milion e 500 mijë lekë**, i rishikuar **123 milione e 570 mijë lekë**, i detajuar si më poshtë:

Tabela 5	(në lekë)
Fondi i Pagave (artikulli 600):	13,800,000
Fondi i Sigurimeve Shoqerore (artikulli 601):	2,700,000
Fondi për Shpenzime Operative (artikulli 602):	5,000,000
Fondi për transfertat ndaj te treteve (artikulli 604):	101,000,000
Fondi për trans për Buxh. Fam. & Individ (artikulli 606):	70,000
Fondi për Investimet e Trupezuara (artikulli 231):	1,000,000
TOTAL:	123,570,000

Analiza e realizimit të treguesve buxhetorë për Vitin 2018

Gjatë vitit 2018 nga ana e institucionit, në zbatim të misionit të tij, janë realizuar aktivitetet duke përdorur fondet buxhetore dhe burimet e brendshme me efience dhe efektivitet, përkatësisht:

Programi “Mbështetje për Shoqërinë Civile”

Tabela 6

Ecuria e realizimit buxhetor per Vitin 2018			
Struktura Buxhetore	Plani (në lekë)	Fakti (në lekë)	Realizimi (në përqindje)
600 - Paga	13,800,000	13,275,359	96 %
601 - Kontribute sig. shoq. shend.	2,700,000	2,195,335	81 %
602 - Mallra dhe Shërbime të Tjera	5,000,000	3,830,059	77 %
604 - Tranferta GRANTE	101,000,000	98,960,000	98 %
606 - Trans per Buxh. Fam. & Individ	70,000	46,631	67 %
231 - Investimet te brendshme	1,000,000	366,120	37 %
Totali	123,570,000	118,673,504	96 %

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (artikulli 600-601), është realizuar në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Vendim nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Statutit të Agjencisë Për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, ndryshuar me Vendimin nr. 789 datë 16.11.2011 të Këshillit të Ministrave “Për një ndryshim në Vendimin nr. 769 datë 15.07.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e statutit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, mbështetur në Ligjit nr.109/2017, datë 30.11.2017 “Për Buxhetin e Vitit 2018”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në zbatim të VKM-së nr.60, datë 31.01.2018 “Për Përcaktimin e numrit të Punonjësve me kontratë të përkohshme për Vitin 2018 në njësitë e Qeverisjes Qendrore”, i ndryshuar, numri mesatar i punonjësve për AMSHC-në është realizuar 14 punonjës të përhershëm si dhe 2 punonjës me kontratë të përkohshme.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, gjatë këtij viti, është realizuar respektivisht:

- ❖ **13,275,359 lekë** (artikulli 600) për paga, realizimi **96%**
- ❖ **2,195,335 lekë** (artikulli 601) për kontribute për sig. shoqërore shendetsore, realizimi **81%**
- ❖ Shpenzimet e Personelit janë realizuar në vlerën **15,470,694 lekë** në total dhe **94%** për vitin 2018.

Fondi për shpenzime për mallra dhe shërbime të tjera (artikulli 602), për vitin 2018 është planifikuar në vlerën **5,000,000 lekë**.

Për gjatë vitit 2018 është realizuar vlera prej **3,830,059 lekë** ose **77%** e planit vjetor për AMSHC-në. Realizimi i fondit për shpenzime operative për nevojat e institucionit në mënyrë analitike pasqyrohet:

Tabela 7

Nr. llogarisë	Emërtimi	Shumat në lekë
020	Materiale zyre dhe të përgjithshme	398,300
6021	Materiale dhe shërbime speciale	2,000
6022	Shërbime nga të tretë	544,909
6023	Shpenzime transporti	630,380
6024	Shpenzime udhëtimi	1,494,761
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	45,600
6026	Shpenzime për qeramarrje	434,180
6029	Shpenzime të tjera operative	279,929
TOTALE		3,830,059

Në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC-ja është mbështetur në parimin e një shpërndarje sa më racionale të kërkesave për ecurinë optimale të veprimatrisë së institucionit si dhe ka zbatuar “Rregjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike” për blerje dhe shërbime të cilat kryesisht lidhen me:

- *Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, ujë, shërbime postare e telefonike, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.*
- *Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevoja të AMSHC-së, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, lyerje dhe mirëmbajtje, pastrim etj.*
- *Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitorë dhe të tretë etj.*
- *Kryerjen e monitorimeve në terren të projekteve që AMSHC ka financuar gjatë vitit 2018.*

Realizimi i plotë i fondit për Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes argumentohet me arsyet si me poshtë vijon:

Gjatë vitit 2018 janë realizuar praktikat e prokurimeve të parashikuara në Rregjistrin e Prokurimeve Publike dhe gjithashtu janë realizuar programet e punës përsa i përket monitorimeve në terren të projekteve që AMSHC-ja ka financuar gjatë vitit 2018.

Fondi për transferta për buxh. fam. & individ (artikulli 606), për vitin 2018 është paraqitur kërkesë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për miratim fondi të veçantë për pagesë shpërblim për dalje punonjësi në pension në vlerën 70,000 lekë, realizuar 46,631 lekë.

Fondi për shpenzim investime (artikulli 231 - për Investime të Trupëzuara), miratuar fond në vlerën **1,000,000 Lekë**.

Gjatë vitit 2018, janë realizuar procedurat e prokurimit dhe ndjekjes përsa i përket fondit të investimeve. Në total për këtë zë janë disbursuar 366,120 lekë që përbën 37% të fondit të investimeve.

Fondi në zërin për Transferime Korrente të Brendshme (artikulli 604), për vitin 2018 është planifikuar në vlerën **101,000,000 leke**. Ky është dhe zëri më me peshë në strukturën e buxhetit të AMSHC-së, duke qenë se dhe vete misioni i institucionit ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet e OJF përfituese.

Edhe për këtë artikull, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **98,960,000 lekë** ose **98%** e planit vjetor. Ndërkohë disbursimet e zërit të Granteve kanë përfshirë disbursime nga Thirrja nr.10 dhe Thirrja nr.11 të organizuara nga AMSHC-ja.

Ecuria e disbursimeve të granteve financiare

Në Tabelën nr. 5 më poshtë, evidentohet ecuria e disbursimeve të granteve financiare.


(Artikulli 604 – Disbursimi i Granteve) gjatë vitit 2018, si dhe në grafikun më poshtë qartësohet kjo ecuri disbursimi në formë grafiku ku shihet që disbursimet e granteve më së shumti janë përqendruar në muajin Gusht, Tetor dhe Dhjetor pas shpalljes së OJF-ve fituese të Thirrjes Nr. 11 sipas përcaktimeve të kontratave lidhur mes OJF-ve dhe AMSHC-së.

Tabela 8

(në lekë)

Grafiku 5

Janar	0
Shkurt	0
Mars	0
Prill	0
Maj	0
Qershor	0
Korrik	0
Gusht	57,950,000
Shtator	1,960,000
Tetor	12,050,000
Nëntor	5,730,000
Dhjetor	21,270,000
TOTAL	98,960,000



AMSHC është një Institucion qendror buxhetor i krijuar me Ligjin Nr. 10093 Date 09.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile” dhe VKM Nr. 769 Date 15.07.2009 “Per Miratimin e Statutit të AMSHC-së” (i ndryshuar), me mision themelor “*Nxitjen e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Shoqërisë Civile*”, si dhe “*Krijimin e kushteve të favorshme për nisma civile*”, në të mirë dhe në interes të publikut.

Për realizimin e Misionit, AMSHC-ja ofron “*asistencë financiare*” për programet, që nxisin e forcojnë qëndrueshmërinë e organizatave jofitimprurëse, bashkëpunimin ndërsektorial e ndërkombëtar, nismat civile, filantropinë, vullnetarizmin e institucionet demokratike të shoqërisë, si dhe programe të tjera si trajnime/ëorkshops/konferenca/takime rajonale që lehtësojnë përmbushjen e misionit të saj.

Duke filluar nga ***muaji Nëntor 2010 e deri në fund të vitit 2018*** Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile udhëhequr nga Bordi Mbikqyrës I AMSHC- së, ka organizuar ***11 Thirrje për Projekt-Propozime*** sipas prioriteteve dhe fushave të cilat janë objektiva të përhershëm të Institucionit, dhe janë kryer procedurat e duhura konform Ligjeve në fuqi në lidhje me njoftimin, shpalljen, vlerësimin, seleksionimin dhe kontraktimin e Organizatave Jofitimprurëse për financimin me Grante të projekteve që kanë rezultuar fituese.

Më tej puna konkrete e AMSHC- së si institucion, mbetet ndjekja e Projekteve deri në fazën finale të realizimit të tyre, Monitorimi dhe Vlerësimi i ecursisë së realizimit të Aktiviteteve konform projektpropozimit dhe kontratës së lidhur mes palëve si dhe Monitorimi dhe Vlerësimi I ecursisë së realizimit financiar të Projekteve të financuara nga AMSHC-ja dhe përputhshmëria me buxhetin e parashikuar si dhe me legjislacioni fiskal dhe tatimor të Republikës së Shqipërisë.

Sasia e granteve dhe Organizatave Jofitimprurëse (OJF) të kontraktuara për t’u Financuar për secilën Thirrje të organizuar nga AMSHC paraqitet si vijon:

Tabela 9

Thirrja	Numri i OJF-ve Perfituese	Vlere e Granteve financiare (në Lekë)
Thirrje Nr.1	52	125,918,000
Thirrje Nr.2	31	16,000,000
Thirrje Nr.3	69	131,960,000
Thirrje Nr.4	63	62,105,000
Thirrje Nr.5	47	55,200,000
Thirrje Nr.6	21	43,755,840
Thirrje Nr.7	41	73,500,000
Thirrje Nr.8	18	36,000,000
Thirrje Nr.9	41	85,200,000
Thirrje Nr.10	35	95,100,000
Thirrje Nr.11	45	107,700,000
TOTAL	463	832,438,840

Duke vlerësuar konstatimet dhe sugjerimet e Ministrisë së Financave përsa i përket Përgatitjes së Fazës së Parë të PBA-së 2019-2021, vlerësojmë se Ekipi i Menaxhimit të Programit gjatë vitit 2018, ka bërë një punë serioze dhe të përgjegjshme në drejtim të respektimit të përcaktimeve të udhëzimit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm përshtatur specifikisht për natyrën e detyrave dhe përgjegjësi që AMSHC mbulon në bazë të Ligjit mbi të cilin është krijuar dhe funksionon prej shumë vitesh.

- *Së pari, pjesë e planeve të punës në baza vjetore për AMSHC- në, është gjithmonë realizimi i takimeve konsultative me përfaqësues të Shoqërisë Civile në Shqipëri me qëllim njohjen me problematikat e hasura, me sugjerimet e tyre lidhur me organizimin e punës në Institucion, sugjerimet e tyre përsa i përket detajimit të zërave buxhetore si dhe përsa i përket aktiviteteve që janë të rëndësishme për t'u organizuar me qëllim përcjelljen e "feedback" të qartë të OJF-ve në punën tonë të përditshme si Institucion që mbështet fuqizimin e një Shoqërie Civile të qënësishme në vend.*
- *Së dyti, në vijim të punës për të realizuar me sukses buxhetimin gjinor, edhe AMSHC-ja përcaktuar produkte/objektiva/aktivitete/kosto të detajuara për arritjen e barazisë gjinore si dhe ka financuar dhe ndjekur projekte me këtë qëllim.*

Sqarim/argumentim: Analiza e realizimit të treguesve sipas përcaktimeve të PBA-së 2019-2021

Tabela 10

Përshkrimi i Programit				
Per realizimin e misionit te saj AMSHC -ja ofron asistence financiare dhe teknike per programet qe nxisin e forcojne qendrushmerine e organizatave joftimprurese, bashkepunimin ndersektorial e nderkombetar, nismat civile, filantropine, vullnetarizmin e institucionet demokratike te shoqerise si dhe programe te tjera qe lehtesojne permbushjen e misionit te saj.				
Qëllimet e Politikës së Programit	Krijimi i kushteve per rritje te qendrushme te shoqerise civile ne vend permes nje shoqerie civile me vibrante dhe pjesemarrrese ne vendimarrje dhe monitorim politikash publike.			
Treguesit e Performancës në nivel Qëllimi	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Me shume perfshirje e Shoqerise Civile ne Monitorimin dhe zbatimin e politikave publike.	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites
Rritje kapaciteti i OJF- ve ne Shqiperi ne terma te perthithjes se fondeve buxhetore nepermjet projekteve te financuara si dhe ne kuader te zbatuesmerise se ketyre projekteve.	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites
Objektivi 1 i Politikës së Programit	Mbeshtetje financiare dhe monitorim per me shume projekte te OJF- ve sipas programeve te percaktuara nga Bordi Mbikqyres i AMSHC -se ne vit ndaj numrit te OJFve qe aplikojne per financime.			

Treguesit e Performancës për Objektivin 1

Numri i OJF -ve mbështetur financiarisht nga AMSHC -ja ndaj totalit të organizatave që kanë aplikuar për financime përgjate vitit. (në përqindje)	28%	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites
Rritje në përqindje e projekteve të financuara nga AMSHC sipas programeve specifike të percaktuara nga Bordi Mbikqyres sipas shperndarjes poshteshenuar	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites
Me shume projekte qe synojne fuqizimin e shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale dhe qëndrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites
Me shume projekte qe synojne mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (jetimët, personat me aftësi të kufizuar, minoritete, LGBTI, etj) nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare;	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites
Me shume projekte qe synojne fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile;	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites	Trend rrites

Produktet për Objektivin 1				
Shpenzimet Korrente*				
Produkti 1	Projekte te financuara nga AMSHC- ja			
Përshkrimi i Produktit:	Ky produkt nenkupton ndjekjen me sukses te procesit te shpalljes se Thirrjes per projektpropozime, vleresimeve te projekteve qe aplikojne prane AMSHC- se per financim bazuar ne Ligjin per Krijimin e AMSHC -se. Pas kesaj shpallen projektet qe do financohen gjithmone sipas programeve te interesit te cilat percaktohen nga Bordi Mbikqyres i AMSHC -se ne bazuar mbi programet strategjike te AMSHC- se si dhe bazuar ne gjetjet e takimeve konsultative te cilat organizohen nga AMSHC- ja para çdo shpallje te Thirrjeve.			
Njësia Matëse	Numri I projekteve te financuara			
	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Sasia	45	60	70	80
Kosto totale (në mijë lekë)	120,000	120,250	120,250	120,750
Produkti 2(shto produkte sipas rastit)	Monitorime/Inpektime ne terren te projekteve te financuara			
Përshkrimi i Produktit:	Projektet e financuara nga AMSHC- ja, ndiqen pergjate vitit dhe monitorohen si nga pikpamja e realizimit te aktiviteteve te pershkrura ne kontrate dhe ky monitorim realizohet ne terren prane OJFve dhe aty ku realizohen aktivitetet, ashtu edhe nga ana financiare persa l takon dokumentave justifikues te OJF-ve ne lidhje me perdorimin e fondit.			
Njësia Matëse	Numer monitorimesh/inpektimesh te kryera			
	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Sasia	45	60	70	80
Kosto totale (në mijë lekë)	2,500	2,750	2,750	3,250
Shpenzimet Kapitale***				
Kategoria 1: Shpenzimet Administrative Kapitale				
Kodi i Projektit të Investimeve****	Blerje pajisje të ndryshme			
Produkti 1	Pajisje/mobilje te blera	Kodi i Projektit sipas listes se investimeve	M880001	
Përshkrimi i Produktit:	Pajisje/mobilje te blera per mirefunksionimin e Institucionit (per sistemin IT si dhe mobilie per Institucionin)			
Njësia Matëse	Numer pajisjesh			
	2018 Buxheti	2019 Parashikimi	2020 Parashikimi	2021 Parashikimi
Sasia	5	5	6	7
Kosto totale (në mijë lekë)	1,000	1,000	1,000	1,000

Puna kryesore e AMSHC-së për Vitin 2018 është përqendruar në realizimin me sukses të Thirrjeve për Projekt-Propozime si dhe ndjekjes/Monitorimit/Vlerësimit të projekteve të zbatuara në kuadër të këtyre Thirrjeve.

KAPITULLI IV

Aktivitetet kryesore të AMSHC-së për vitin 2018



Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 11 janar 2018

Ky takim pune u zhvillua pranë ambjenteve të “Qendrës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri” (CRCA Shqipëri). Anëtarët e KKSHC-së diskutuan rreth vendosjes së disa prioriteteve bazë për punën sipas grupeve specifike, por dhe sipas nevojave të sektorit.

Gjithashtu gjithë të pranishmit ishin të mendimit që t’i dërgohet një letër Kryetares së KKSHC-së, ku të kërkohej që të gjitha institucionet publike të dërgojnë

pranë Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile emrat e anëtarëve të KKSHC-së për t’i pasqyruar në faqen web të Agjencisë si dhe pjesëmarrja e tyre në takimet e Këshillit pasi mos prezenca e tyre e vështirëson punën për funksionimin e Këshillit.

U krijuan tri grupe pune për rishikimin dhe amendimin e ligjeve. Një për Ligjin e OSHC-ve, një për Ligjin e taksave dhe një për Ligjin e pushtetit vendor.



AMShC shpall Thirrjen nr. 11 për shprehje interesi

11 janar – 12 shkurt 2018

Në këtë Thirrje ftohen OJF-të e interesuara të sjellin projekt-propozime që kanë si objekt dhe mbulojnë fushën prioritare:

1. **Kujdesi ndaj mjedisit dhe ambientit, duke promovuar nisma ndërgjegjësuëse dhe aksione të tjera në drejtimin e mirëmbajtjes ambientale dhe territoriale dhe prioritetet e tjera:**
2. **Fuqizimi i kapaciteteve rinore në fushën e vullnetarizmit, trajnimeve, sipërmarrjes sociale, turizmit dhe arsimit gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm si dhe protagonizmit në krijimin e organizatave të shoqërisë civile;**
3. **Mbështetje për shtresat në nevojë dhe grupet e marginalizuara të shoqërisë (jetimët, personat me aftësi të kufizuar, minoritete, LGBTI, etj) nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të tyre dhe aksioneve të përfshirjes komunitare;**
4. **Fuqizimi i shtetit të së drejtës, nëpërmjet mbështetjes së iniciativave që kanë në fokus luftën ndaj korupsionit, qytetarinë aktive, rritjen e pjesëmarrjes qytetare në vendimarrjet lokale dhe qendrore si dhe advokacinë për nisma ligjore;**
5. **Turizmi dhe kultura, si një binom zhvillimi për territorin e Shqipërisë, nëpërmjet iniciativave që kanë si qëllim rritjen e përdorimit të resurseve turistike dhe kulturore, të ndërthurura me protagonizmin rinor dhe atë të shoqërisë civile**

AMShC merr pjesë në workshop mbi luftën kundër Korrupsionit

Tiranë, 16 janar 2018



Përfaqësues nga AMShC marrin pjesë në një workshop me titull “Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit: Nga Objektivat në Treguesit e Performancës”, të organizuar në kuadër projektit “Studim i masave në Reformën kundër korrupsionit”, i cili financohet nga Bashkimi Evropian dhe implementohet nga ARS Progetti. Ky workshop kryesohet nga znj. Teuta Vodo, Zëvendësministre e Drejtësisë, në cilësinë Koordinatorit Kombëtar të Anti – Korrupsionit.

Mbyllet procesi i konsultimit online mbi Udhërrëfyesin

31 janar 2018

Konsultimi On-Line

UDHËRRËFYESI PËR HARTIMIN E POLITIKËS DHE MASAVE PËR NJË MEDIË
MUNDËSUES PËR SHOQËRINË CIVILE



Ekipi i Asistencës Teknike shpreh mirënjohjen e saj për 20 organizatat që morën pjesë aktivisht në konsultim dhe të gjitha ato 350 organizata, të cilat i hodhën një vështrim dokumenteve, edhe pse nuk e plotësuan pyetësoin. Ky konsultim kishte për qëllim të kontribuonte për një njohje më të mirë të Udhërrëfyesit. Gjithashtu, një përmbledhje anonime me të gjitha përgjigjet do të publikohet nga mesi i muajit Prill si dhe një version të rishikuar i Udhërrëfyesit sa më shpejt të jetë e mundur.



Tiranë, 5 shkurt 2018

Zhvillohet pranë zyrave të AMShC-së, në orën 10:15 një takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) me ekspertë të BE-së.

AMShC mbështet nismën kundër dhunës ndaj grave #DashuriaNukVret #Dashuromosvrit

Tiranë, 14 shkurt 2018

Një mesazh i fortë kundër dhunës ndaj grave është realizuar nëpërmjet disa graffiti në qytetin e Tiranës, ku kundërshtohet me forcë tendenca e shoqërisë për t'i justifikuar vrasjet e dhunshme të grave me etiketimin "krim pasioni".

Gjatë gjithë vitit, gratë dëgjojnë t'u thuhet: Kush të rreh të do!

Gjatë gjithë vitit, gratë dëgjojnë t'u thuhet: Fati i gruas janë lotët!

Gjatë gjithë vitit, gratë dëgjojnë t'u thuhet: "Grueja asht shakull për me bajtë".

Ndërkohë çdo 14 shkurt, gratë shqiptare dëgjojnë t'u thuhet sa shumë i duan burrat i tyre, ato marrin dhurata, lule dhe çokollata.

Afërsisht çdo dy javë gratë vriten prej burrave të tyre me thika, sëpata dhe plumba.

Por dashuria e vërtetë nuk vret! Krimi i pasionit është thjesht krim! Pasioni nuk rreh, as vret!

Kush dashuron nuk ngre dorë ndaj njeriut që do! Kush të rreh NUK të do!

Prandaj Dashuro, Mos Vrit!

#DashuriaNukVret #Dashuromosvrit



Konferencë për Prezantimin e Raportit EITI 2016 dhe promovimin e Transparencës në aktivitetin e shfrytëzimit të Burimeve Natyrore në Shqipëri

Tiranë, 28 shkurt 2018



Përfaqësues nga AMSHC merr pjesë në Konferencën “Prezantim i Raportit EITI 2016 dhe promovimi i transparencës në aktivitetin e shfrytëzimit të burimeve natyrore në Shqipëri”, organizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bashkëpunim me Sekretariatit Kombëtar të Transparencës për Industrinë Nxjerrëse Alb EITI.

Në këtë Konferencë ishin të pranishëm Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Enis Aliko, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë z. Gentian Keri, Drejtori i Sekretariatit Kombëtar të Iniciativës Globale për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse z. Ardit

Kamberi, Kryetari i Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin në Kuvendin e Shqipërisë, z. Eduart Shalsi, si dhe Përfaqësues nga institucionet shtetërore, Përfaqësues të Trupit Diplomatik, Përfaqësues të Donatorëve dhe Partnerëve Ndërkombëtarë, Përfaqësues nga Shoqëria Civile, si dhe Përfaqësues të Bisnesit të Industrive Nxjerrëse.

Publikimi i të dhënave të Raportit Zyrtar Vjetor EITI 2016, finalizon aktivitetin vjetor të Sekretariatit Kombëtar EITI, me fokus në promovimin e Transparencës dhe Mirëadministrimin e Burimeve natyrore të vendit, fryt edhe i bashkëpunimit me MSG dhe Grupet e Interesit.

Tryezë e rrumbullakët “Shërbime pa Barriera” me Organizata të Shoqërisë Civile që përfaqësojnë grupe të marginalizuara me aftësi ndryshe

Tiranë, 28 shkurt 2018



Agjencia e Ofritit të Shërbimeve të Integruara në Shqipëri (ADISA) në bashkëpunim me Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) dhe partnerët e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "IPSD - Mbështetje për përmirësimin e ofritit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri" si dhe nën prezencën e Zëvendëskryeminstres së Shqipërisë, Znj. Senida Mesi, organizuan tryezën e rrumbullakët “Shërbime pa Barriera”, e cila u mbajt në ambientet e Hotel Tirana International.

Në këtë tryezë morën pjesë Organizata të Shoqërisë Civile, të cilat përfaqësojnë grupe të marginalizuara me aftësi ndryshe.



Tiranë, 28 shkurt 2018

Zhvillohet pranë zyrave të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) rreth orës 12:30 një takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) me ekspertin BE-së.

Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 6 mars 2018



Mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), e cila u organizua pranë ambienteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri dhe në praninë e mediave. Morën pjesë anëtarë të KKShC-së, përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe organizata të shoqërisë civile.

Në këtë mbledhje diskutua për nismat ligjore të prezantuar nga anëtarët e shoqërisë civile në KKShC; informacion mbi procesin e rishikimit të Udhërrëfyesit; njohja e Udhëzimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës për përzgjedhjen e 5 (pesë) anëtarëve të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, etj.



Dita Ndërkombëtare e Gruas

Tiranë, 8 mars 2018

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) dhe Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) marrin pjesë në eventin e organizuar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas si dhe u mbajt një konferencë me temë: “Roli i gruas shqiptare në shtetformim, modernizim



dhe europianizim”. Në këtë aktivitet morën pjesë ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, përfaqësues nga shoqëria civile, bota akademike, anëtarë të trupit diplomatik të akredituar në Shqipëri, politikanë, etj.

Ky event u organizua me synim sensibilizimin e shoqërisë rreth respektimit të të drejtave të grave, fuqizimit të rolit të tyre dhe barazisë gjinore, të mishëruara këto në politikat aktuale të qeverisë shqiptare dhe angazhimin për të përqafuar vlerat evropiane me anë të procesit të anëtarësimit. Pjesë e eventit do të jetë një ekspozitë arkivore e grave shqiptare përgjatë historisë dhe dokumente të Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATSH), Arkivit Qendror të Shtetit dhe Arkivit të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, për rolin e grave shqiptare në diplomaci.



Thirrje për aplikim të kandidatëve nga shoqëria civile për Këshillin Kombëtar për Të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

15 – 20 mars 2018

AMSHC në rolin e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) shpall Thirrjen për aplikim të kandidatëve nga shoqëria civile për 5 (pesë) vende anëtarë të për Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF), në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 40, datë 1.3.2018 “Për ngritjen e Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF)”.



Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile

Tiranë, 4 prill 2018

Zhvillohet pranë zyrave të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) rreth orës 10:00 një takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), përfaqësues nga AMShC dhe ekspertin e Asistencës Teknike.

Pikat e axhendës së takimit:

- Raporti vjetor i KKShC-së dhe modelet e raportimit
- Planin afatgjatë të punës së KKShC-së 2018-2020
(në bazë të planit të punës për 2018, tashmë të miratuar)
- Aktet nënligjore të kodit të sjelljes, të anëtarëve të organizatave të shoqërisë civile
- Përditësimet e buxhetit të KKShC-së
- Politikat e rimbursimit të udhëtimit të KKShC-së

Tryezë e rrumbullakët mbi përgatitjen e shoqërisë civile shqiptare për negociatat e pranimit në BE

Tiranë, 12 prill 2018



Projekti i financuar nga BE "Asistencë Teknike për të promovuar një mjedis më të mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri" në bashkëpunim me Zyrën e Kryeministrit organizuan workshop-in "Përgatitja e Shoqërisë Civile Shqiptare për Pranimin në BE, shkëmbimin e praktikave dhe eksperiencave me vendet e tjera në rajon", i cili u mbajt më datë 12 prill 2018, pranë ambjenteve të Rogner Hotel, Tiranë. Të ftuar në këtë tryezë të rrumbullakët ishin anëtarë të shoqërisë civile në Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile në vend, përfaqësues nga Qeveria shqiptare, Delegacioni i BE-së në Shqipëri dhe anëtarët e ekipit të Asistencës Teknike.

Aktiviteti u mbështet nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC).

Qëllimet e kësaj tryeze e rrumbullakët:

1. Mbështetje për shoqërinë civile shqiptare për t'u përgatitur më mirë për hapjen e negociatave të pranimit në BE
2. Mbështetje Qeverisë shqiptare në akomodimin e rolit të shoqërisë civile brenda procesit të negociatave të pranimit
3. Ndarje e përvojave rajonale në negociatat e pranimit dhe angazhimin e shoqërisë civile midis shteteve anëtare dhe vendeve candidate
4. Identifikimi i hapave të radhës në përfshirjen e shoqërisë civile në strategjinë e negociatave të Shqipërisë në BE dhe në Udhërrëfyesin për një Mjedis Mundësues për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Punimet e kësaj tryeze i përshëndetën z. Stephen Stork - Përfaqësues nga Delegacioni i BE në Shqipëri; znj. Orjana Arapi - Përfaqësuese nga Zyra e Kryeministrit; z. Sokol Dedja - Përfaqësues nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; z. Blendi Dibra - Zv. Kryetar i Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile dhe z. Andi Kananaj - Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Më pas u vijua me prezantimet mbi praktikën e mira dhe sfidat në përfshirjen e OSHC-ve në procesin e negociatave nga tre ekspertët e huaj nga Serbia, Kroacia dhe Mali i Zi.

Gjithashtu zhvilluan punë në grupe të OSHC-të për negociatat me BE dhe u bë prezantimi i përfundimeve dhe diskutimeve:

- Kapitulli 23 (gjyqësori dhe të drejtat themelore)
- Kapitulli 24 (drejtësi, liri dhe siguri)
- Kapitulli 26 (arsim dhe kulturë)



Progres-Raport mbi transparencën dhe konsultimet publike

Shkodër, 25 prill 2018



Në kuadër të projektit "Rinia Guxon", mbështetur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë" organizoi një takim, ku u prezantua Progres-Raporti mbi zbatimin e transparencës dhe procesin e konsultimeve publike në Bashkinë Shkodër.



Takime tematike me KKSHC për Udhërrëfyesin e Rishikuar

Tiranë, 25, 26, 27 prill 2018

Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në bashkëpunim me Ekspertizën Teknike organizuan një raund paraprak takimesh për të informuar dhe konsultuar me anëtarët e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) lidhur me dokumentin e rishikuar të Udhërrfyesit.

Këto takime u organizuan në ambjentet e Kryeministrit, sipas drejtimeve strategjike të përcaktuara në dokument dhe morën pjesë përfaqësues nga KKShC si edhe përfaqësues të strukturave/institucioneve shtetërore sipas tematikave:

- **Datë 25 prill 2018**
Drejtimi strategjik 1:
Bashkëpunim i institucionalizuar i qeverisë me shoqërisë civile në hartimin e politikave dhe integrimin në BE
- **Datë 26 prill 2018**
Drejtimi strategjik 2:
Një mjedis ligjor mundësues dhe qeverisja e të dhënave/informacionit
- **Datë 27 prill 2018**
Drejtimi strategjik 3:
Mundësimi i kuadrit fiskal dhe financimit

Prezantohet për herë të parë koncepti “Linja Kombëtare e Ndhmës Ligjore Falas për Fëmijët dhe të Rinjtë e Pambrojtur ne Shqipëri”

Tiranë, 30 prill 2018



Zyra për Mbrojtjen Ligjore CRCA Shqipëri, ALO 116 dhe Ambasadën PINK, me mbështetjen e zyrës së PNUD dhe Ministrisë së Drejtësisë organizuan, në ambientet e COD, eventin ku prezantuan për herë të parë konceptin e “Linjës Kombëtare për Ndhmë Ligjore Falas për Fëmijët dhe të Rinjtë e Pambrojtur në Shqipëri”.

Në takim ishin të pranishëm znj. Vasilika Hysi, deputete në Kuvendin e Shqipërisë, Kryetare e Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut; znj. Edlira Papavangjeli, Menaxhere e Programit për Barazi Gjinore pranë UNDP-së; një përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) dhe Ministria e Drejtësisë; përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile etj.

Takimin e hapi z. Altin Hazizaj, i cili bëri një përmbledhje të gjitha arritjeve dhe vështirësive të hasura deri më sot si dhe prezantoi shkurtimisht qëllimin dhe objektivat e këtij koncepti.

Në fjalën e tij ai theksoi se kjo zyrë funksionon që prej vitit 2001 me fokus mbrojtjen nga shkeljet e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri nga administrata dhe institucionet publike.

Nga vitit 2001 janë ndjekur më shumë se 150 çështje dhe mbi 2000 fëmijë dhe të rinj kanë përfituar nga shërbimet e kësaj zyre në të gjithë Shqipërinë. Mbrojtja dhe këshillimi ligjor, avokatësia për të drejtat dhe aksesin në drejtësi, janë prioritetet kryesore të Zyrës.

Takimin e përshëndeti znj. Vasilika Hysi, e cila theksoj rëndësin e këtij

koncepti dhe vuri theksin te bashkëpunimi me institucionet ligjvënëse dhe ligjzbatuese për t’iu ardhur sa më denjësisht në ndihmë fëmijëve dhe të rinjve të pambrojtur. Po ashtu, fjalën e morën edhe përfaqësueset e UNDP-së dhe Ministrisë së Drejtësisë, të cilat theksuan rëndësinë e kësaj Linje, arritjet e këtij bashkëpunimi dhe premtuan forcimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

Më tej u kalua në prezantimin e konceptit, u bënë komentet dhe sugjerimet në funksion të një projekti sa më cilësor dhe gjithëpërfshirës. Nuk munguan as pyetjet dhe përgjigjet, të cilat hodhën dritë mbi disa paqartësi të veçanta.

Në mbyllje të takimit organizatorët falënderuan të pranishmit për mendimet edhe sugjerimet e tyre.

Raporti i monitorimit të transparencës për Gjykatat

Shkodër, 2 maj 2018



Në kuadër të projektit "Rinia Guxon", mbështetur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë" organizoi një takim, ku u prezantua “Raporti i monitorimit të transparencës për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër”, i cili u mbajt pranë ambienteve të Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Prezantimi u zhvillua me studentët e Fakultetit të Drejtësisë, të cilët patën mundësi të jenë vetë ata që vizituan website-et e Gjykatave duke vënë re progresin e arritur në publikimin e informacioneve të detyrueshme sipas ligjit, për të drejtën e informimit.

Tryezë e rrumbullakët për respektimin e të drejtave të njeriut

Tiranë, 4 maj 2018



Në kuadër të projektit të financuar nga BE për "Mbështetje në përmirësimin e Shërbimeve Publike me në qendër Qytetëtarin – IPSD", "Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara – ADISA" me mbështetjen e Delegacionit të BE-së organizuan një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të Shoqërisë Civile me fokus të drejtat e njeriut në Shqipëri, e cila u mbajt në ambjentet e Hotel Tirana International. Qëllimi i kësaj tryeze ishte informimi i grupeve të interesit (OSHC për të drejtat e njeriut; barazinë gjinore; të drejtat e fëmijëve/të rinjve dhe komuniteti LGBT) me atë çka ofron Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara - ADISA, sikurse mbajtja shënim e nevojave dhe problematikave të posaçme që këto grupe hasin në përditshmërinë e tyre, me synim përmirësimin e këtyre shërbimeve në të ardhmen.

AMShC lançon Platformën online "PROMOVIMI I SHOQËRISË CIVILE"

Tiranë, 7 maj 2018



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) lançon Platformën online "PROMOVIMI I SHOQËRISË CIVILE" – www.amshc.gov.al/promo. "PROMOVIMI I SHOQËRISË CIVILE" është një platformë e hapur komunikimi dhe ndërveprimi me Organizatat të Shoqërisë Civile.

Kjo platformë do të shërbejë për promovimin e projekteve dhe aktiviteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile si dhe shkëmbimit të ideve nëpërmjet forumeve. Për më shumë informacion vizitoni: www.amshc.gov.al/promo

Përtej Barrierave – Trajnim për European Voluntary Service (EVS)

18 – 19 maj 2018

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në trajnimin dy ditor të organizatave të shoqërisë civile për European Voluntary Service (EVS), të organizuar nga Organizata "Përtej Barrierave".



Takim konsultues me organizata të shoqërisë civile mbi Programin IPA 2015

Tiranë, 24 maj 2018

Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme zhvilloi një takim konsultues me Organizata të Shoqërisë Civile në kuadër të zbatimit të komponentit për mbështetje të Shoqërisë Civile nga Programi IPA 2015 – Instrumenti Lehtësues për Integrimin Evropian. Ky aktivitet u mbështetet edhe nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC).

Dokumenti i Veprimit i Instrumentit Lehtësues për Integrimin Evropian, si objektiv të përgjithshëm ka forcimin e kapaciteteve dhe llogaridhënies së administratës shtetërore, në mënyrë që të garantojë një rol të qëndrueshëm të Qeverisë për t'u përgatitur për anëtarësimin në BE.

Raporti i Progresit për Shqipërinë i 2017 thekson rëndësinë e përfshirjes së Shoqërisë Civile në procesin e Integritimit Evropian: “Nevojiten përpjekje të konsiderueshme për të siguruar konsultime kuptimplotë me aktorët e shoqërisë civile, si pjesë e dialogut politikë gjithëpërfshirës. Qëndrueshmëria financiare e organizatave të shoqërisë civile mbetet një sfidë për shkak të kuadrit fiskal dhe ligjor”.

Takimi konsultativ shërben si bazë për të identifikuar nevojat e Shoqërisë Civile për të dhënë kontributin e tyre maksimal në procesin e integritimit të vendit në BE.



Takim pune i anëtarëve të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile Tiranë, 30 maj 2018



Anëtarë të shoqërisë civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) zhvilluan një takim pune, i cili u mbajt pranë ambjenteve të “Shtëpisë së Evropës” – Tiranë.

Tema e takimit: 1. Vlerësimi i çështjeve të ngritura; 2. Përcaktimi i vazhdimësisë dhe i hapave konkrete që duhet të ndërmerren.

Sesion informues të Programeve IPA Cross-Border Greqi-Shqipëri

Gjirokastrë, 4 qershor 2018



Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Andi Kananaj dhe Përgjegjësi i Sektorit të Zhvillimit të Projekteve, z. Erion Banushi, marrin pjesë në takimin e organizuar në qytetin e Gjirokastrës lidhur me implementimin e Thirrjes së Parë dhe të Dytë për projekt-propozimet. Këto projekt-propozime orientohen në Programet e Bashkëpunimit IPA Cross-Border Greqi-Shqipëri të cilat janë pjesë e fushatës informuese mbi aplikimin. Pjesëmarrësit në takim, janë organizata të shoqërisë civile dhe subjekte me të drejtë aplikimi në funksion të programit. Ditët informuese të programit do të vijojnë edhe më tej me realizim të të tjerë takimeve të kësaj natyre.

Projekti IDEA “Zhvillimi i Investimeve dhe Veprime Fuqizimi”

Vlorë, 11 qershor 2018

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Andi Kananaj dhe Përgjegjësi i Sektorit të Zhvillimit të Projekteve, z. Erion Banushi, marrin pjesë në takimin e Projektit IDEA “Zhvillimi i Investimeve dhe Veprime Fuqizimi”, në kuadër të Programit INTERREG IPA CBC GREECE – ALBANIA. Ky aktivitet organizohet nga AULEDA – Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Lokal, Vlorë, në cilësinë e Partnerit Lider, i cili u zhvillua pranë ambjenteve të Hotel Palace, Vlorë. Të pranishëm të tjerë Kryetari i Bashkisë Himarë, Partnerët e projektit si dhe aktorë të tjerë lokal.

Projekti ka për qëllim krijimin e një portal informacioni nëpërmjet të cilit do të mundësohet planifikimi i pjesëmarrjes së ndërhyrjeve sociale, krijimi i modeleve hibride, i mjeteve për financim dhe tërheqjen e investitorëve.



Vizitë studimore mbi shoqërinë civile në Shqipëri e Delegacionit të Ukrainës

Tiranë, 18 – 19 qershor 2018

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), në kuadër të projektit “Rritja e kapacitetit institucional të Qeverisë së Ukrainës dhe Organizatave të Shoqërisë Civile për të zbatuar në mënyrë efektive projekte të përbashkëta”, organizoi disa takime të përbashkëta me përfaqësues të Delegacionit të Ukrainës dhe institucioneve shtetërore shqiptare; anëtarëve përfaqësues nga shoqëria civile të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC) dhe përfaqësuesve nga organizata të shoqërisë civile. Sipas projektit, kjo vizitë studimore zhvillohet në Shqipëri në datat 18 – 19 qershor 2018 dhe Spanjë në datat 21 – 22 qershor 2018.

Delegacioni i Ukrainës, një pjesë e të cilëve ishin anëtarë të Këshillit Koordinues të Shoqërisë Civile në Ukrainë, përbëhej nga:

- **Përfaqësues nga institucionet publike:**
Ministria e Rinisë dhe Sporteve; Administrata e Presidentit të Ukrainës; Ministria e Financave; Shërbimi Fiskal Shtetëror i Ukrainës; Ministria e Politikave Sociale; Sekretariati i Kabinetit të Ministrave
- **Përfaqësues nga Organizata të Shoqërisë Civile**
- **Staf i Zyrës së Koordinatorit të Projektit të OSBE-së në Ukrainë**

Kjo vizitë studimore u organizua nga Zyra e Koordinatorit të Projektit të OSBE-së në Ukrainë.

Gjatë viteve 2016-2017, kjo Zyrë ka mbështetur Administratën e Presidentit dhe Qeverinë e Ukrainës për të zhvilluar një kornizë legislative mbi mekanizmin e financimit për të mbështetur zhvillimin e shoqërisë civile në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për zhvillimin e shoqërisë civile gjatë 2016-2020.

Qëllimi i vizitës studimore është të mësohet përvoja ndërkombëtare prej dy shteteve pjesëmarrëse OSBE-Shqipëri

dhe Spanjë, ku praktikantët mbi mekanizmat e financimit shtetëror / buxhetor dhe burimet për të mbështetur organizatat e shoqërisë civile janë të ngjashme me ato të propozuara në projektligjin për Fondin Kombëtar në Ukrainë dhe kështu, mund të aplikohet në Ukrainë: specifikisht, në kontekstin e Shqipërisë, nëpërmjet një mekanizmi të një Agjencie për mbështetjen e shoqërisë civile, ndërsa në kontekstin e Spanjës, një mekanizëm i një përqindje subvencioni për OSBE-të.



Tiranë, 18.06.2018

Takim i përfaqësuesve të Delegacionit të Ukrainës me përfaqësues nga institucionet shtetërore shqiptare



Tiranë, 18.06.2018

Takim i përfaqësuesve të Delegacionit të Ukrainës me përfaqësues nga institucionet shtetërore shqiptare



Tiranë, 19.06.2018

Takim i përfaqësuesve të Delegacionit të Ukrainës me anëtarë të Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)



Tiranë, 19.06.2018

Takim i përfaqësuesve të Delegacionit të Ukrainës me përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile

IRSH publikon Raportin e I-rë mbi transparencën në Gjykata

Shkodër, 25 qershor 2018



Në kuadër të projektit "Rinia Guxon", mbështetur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë" prezantuan "Raportin e I-rë mbi Transparencën në Gjykata: Gjykata e Rrethit Gjyqësor dhe Administrative e Shkallës së Parë, Shkodër". Shoqata "Intelektualët e rinj, Shpresë" e cila

është angazhuar plotësisht në mbështetjen e reformës në drejtësi dhe rritjen e aksesit në drejtësi që nga muaji Gusht 2017 ka filluar monitorimin e nivelit të transparencës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Shkodër dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ka publikuar Raportin e parë mbi Transparencën në Gjykata duke u fokusuar në zbatimin e ligjit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit".

Me qëllim për të ndërtuar një bashkpunim sa më të mirë në funksion të realizimit të këtij raporti monitorues janë bërë 3 kërkesa për takime të drejtepërdrejta me titullaret e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Ministrisë së Drejtësisë, nga të cilat vetëm Ministria e Drejtësisë shprehu gatishmerinë për tu takuar duke na

dhënë mundësinë për të bërë një prezantim të projektit, mënyrës së zbatimit dhe rendësisë së tij.

Rezulton se Gjykata administrative Shkodër plotëson vetëm 12 nga 28 kriteret që përcakton ligji 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" ose e shprehur në përqindje 42% të tyre ndërsa Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Shkodër plotëson vetëm 11 nga 28 kriteret që përcakton ligji ose e shprehur në përqindje vetëm 39% prej tyre.

Për grumbullimin e informacionit zyrtarë drejt Gjykatës së rrethit gjyqësorë Shkodër janë dërguar 14 kërkesa për informim nga të cilat nuk është kthyer asnjë përgjigje brenda afatit ligjor 10-ditore.

Për grumbullimin e informacionit zyrtarë, drejt Gjykatës Administrative të Shkallës së parë janë dërguar 14

kërkesa për informim ku formalisht është kthyer përgjigje brenda afatit ligjor por pa u dhënë i plotë informacioni i kërkuar. Informacioni i plotë është siguruar vetëm për 7 kërkesa për informim, për 5 kërkesa të tjera përgjigja ka qënë e pjesshme, 1 kërkesë i është referuar institucioneve të tjera, ndërsa për 1 kërkesë përgjigja nuk është dhënë në formën e kërkuar dhe të përcaktuar sipas ligjit.

Për sigurimin e informacioneve nga Gjykata Administrative e Shkallës së parë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë ndjekur rruget e ankimit administrative pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe institucionit të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, ku janë depozituar 4 ankime, të cilat janë pranuar duke bërë të mundur sigurimin e pjesshëm të informacionit të kërkuar. Për nevojat e këtij raporti

janë monitoruar faqet zyrtare të internetit të Gjykatës Administrative Shkodër dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga ku është vëzhguar nëse janë vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre të internetit kategoritë e informacionit të kërkuara sipas ligjit. Progresi dhe ecuria e të dy gjykatave në përditesimin e faqeve të internetit që administrohet prej tyre gjatë periudhës së monitorimit ka qënë e kënaqshme.

Raporti ndër të tjera rekomandon se Gjykatat duhet që të vlerësojnë respektimin e procedurave dhe afateve ligjore për kthimin e përgjigjeve dhe adresimin e kërkesave/ankesave për të garantuar të drejtën e informimit duke dhënë informacionin e kërkuar brenda afateve ligjore.

Rekomandohet që faqja zyrtare e Gjykatave të përditësohet në mënyrë korrekte me informacionet të cilat i

shërbejnë qytetarëve dhe rritjes së transparencës e gjykatave por edhe do të lehtësonte njëkohësisht edhe shërbimin e tyre ndaj qytetarëve duke i adresuar ato drejt informacionit online.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti synojnë që të inkurajojnë drejtuesit e gjykatave në drejtim të rritjes së vazhdueshme të nivelit të transparencës duke ofruar informacionin për qytetarët në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të ku-ptueshme për të ndikuar në rritjen e aksesit në drejtesi si dhe të shërbimeve gjyqësore.

Raportin e plotë mund ta lexoni duke klikuar linkun:

http://irsh.al/wp-content/uploads/2018/06/Rapmon_te_gjyk_2018.PDF



Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC)

Tiranë, 22 qershor 2018



Mbahet mbledhja e radhës e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKShC), e cila u organizua nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), pranë ambjenteve të Qendrës për Hapje dhe Dialog (COD), në Kryeministri e hapur për mediat dhe me të ftuar nga organizata të shoqërisë civile.

Në këtë mbledhje u miratua Procesverbali i mbledhjes së Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) të mbajtur më datë 6 mars 2018; u prezantua procesi i ndjekur për rishikimin e Udhërrëfyesit; u prezantua dhe miratua përmbajtja e Udhërrëfyesit; u prezantuan pesë emrat më të votuar online nga anëtarët e KKSHC-së të zgjedhur anëtarë nga shoqëria civile për Këshillin Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF); u prezantua dhe miratua Drafti i Deklaratës së KKSHC-së në mbështetje të SDG-ve etj.



DEKLARATË MBI OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM NË KUADËR TË AXHENDËS 2030 TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Tiranë, 22 qershor 2018

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs), të cilat hynë në fuqi në janar 2016, janë një grup i ri universal i synimeve ekonomike, sociale dhe mjedisore që shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara pritët të arrijnë deri në vitin 2030.

SDG-të edhe pse nuk janë të detyrueshme, ato përfaqësojnë një angazhim politik mbi zhvillimin nga të gjitha vendet anëtare të OKB-së. Këto qëllime universale pritët të krijojnë një pikë referimi që siguron balancimin e zhvillimit ekonomik dhe qëllimeve globale mjedisore me objektivat e reduktimit të varfërisë.

Shqipëria i është bashkuar Partneritetit Global, i projektuar për të dhënë një kontribut në arritjen e Agjendës 2030 dhe mbetet plotësisht e angazhuar për zbatimin e saj dhe në kontekstin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet dhe në procesin e Integritetit Evropian.

Deri më sot, diskutimet mbi SDG-të kanë qenë të lidhura kryesisht me përcaktimin e qëllimeve dhe treguesve. Më pak vëmendje i është kushtuar diskutimit të roleve dhe përgjegjësisë që duhet të marrin partnerët social në arritjen e këtyre qëllimeve dhe zbatimit në nivel qendror dhe lokal këtë të kësaj kornize universale.

Duke pasur parasysh qëllimet dhe ambiciet e SDG-ve, është e qartë se

Qeveria e vetme nuk mund t'i arrijë dhe t'i përmbushë këto qëllime.

Ajo duhet të lehtësojë dhe të mundësojë pjesëmarrjen e të gjithë sektorëve të shoqërisë, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile (OSHC), sektorin privat dhe publikun e gjerë.

Përfshirja e OSHC-ve në këto procese është e domosdoshme, sepse ato luajnë rol vendimtar në shoqëri si agjentë të llogaridhënies, mobilizimit shoqëror, avokatësisë dhe ofrimit të shërbimeve.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile e konsideron hyrjen në Bashkimin Evropian si prioritetin kryesor dhe qëllimin më të rëndësishëm strategjik të vendit, pasi procesi i integritetit mbart konsensus të plotë politik dhe mbështetje mbarëkombëtare, duke u shndërruar në një mjet solid për të arritur një të ardhme më të mirë dhe të qëndrueshme për qytetarët e Shqipërisë.

Këshilli vlerëson përpjekjet e ndërmarra për të lidhur SDG-të me objektivat e integritetit në BE, duke iu referuar Strategjisë Kombëtare për Integritetin Evropian 2014-2020.

Në këtë proces, shoqëria civile luan një rol kritik në nxitjen e advokimit dhe ndërmjetësimin në zhvillimin e politikave publike, identifikimit të prioritetëve kryesorë të zhvillimit dhe prezantimet të

alternativave për zgjidhje praktike të problemeve prioritare.

Në mënyrë të veçantë nxisim OSHC-të të punojnë për t'i përmbledhur këto qëllime në katër fusha kryesore:

1. duke u dhënë një zë qytetarëve më të varfër dhe më të marginalizuar,
2. duke shërbyer si agjentë të llogaridhënies,
3. duke vepruar si ofrues shërbimesh dhe
4. duke monitoruar zhvillimin përmes mbledhjes së të dhënave dhe raportimit.

Një vëmendje të veçantë merr për ne iniciativa që paraprin objektivin e Zhvillimit të Qëndrueshëm: "Leave no one behind" - "Askush i braktisur", që reflekton ambicjen për një proces gjithëpërfshirës, ku qeveria hyn në partneritet me të gjithë sektorët e shoqërisë e ku "Agenda 2030" e thekson qartë rolin e shoqërisë civile për të përfshirë në këtë iniciativë të gjithë grupet e interesit, por kryesisht ata në nevojë.

Për këtë arsye, është e rëndësishme të krijohen mundësi, hapësira dhe platforma për të mbështetur fuqizuar dhe angazhuar shoqërinë civile në mënyrë që të promovohet dialogu, bashkëpunimi i qëndrueshëm ndërmjet OSHC-ve dhe Qeverisë për të nxitur pjesëmarrjen e komunitetit në drejtim të përmirësimit të qeverisjes.

SDG-të përbëjnë një referencë globale legjitime për OSHC-të, të cilat mund të propozojnë përfshirjen e shumë çështjeve në rrafshin e hartimit të politikave. OSHC-të duhet të identifikojnë përmirësime dhe ndërhyrje që mund të sjellin një ndryshim të rëndësishëm për njerëzit në nevojë duke përkthyer zërin e qytetarëve të varfër dhe të marginalizuar në argumente racionale për t'u adresuar nga pushteti qendror dhe lokal.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile vlerëson si të rëndësishëm zhvillimin e marrëdhënieve dhe partneritetit me qeverinë qendrore dhe lokale, dhe në veçanti, identifikimin e strukturave të qeverisë, aktorëve apo institucioneve përgjegjëse për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që has shoqëria.

Ne inkurajojmë të gjitha përpjekjet e shoqërisë civile për të luajtur rolin kritik dhe transformues në shoqërinë

shqiptare duke u përfshirë në proceset e konsultimit dhe advokimit, duke mundësuar informimin, ngritjen e kapaciteteve dhe të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset vendimarrëse dhe përbushjes së SDG-ve.

Në linjë me zbatimin e SDG-ve, mbledhja e të dhënave, raportimi dhe monitorimi duhet të jetë një proces gjithëpërfshirës dhe transparent që përfshin ekspertë statistikorë, OSHC-të, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, ofruesit e shërbimeve dhe qytetarët.

Në këtë proces, përtej kontributit dhe ekspertizës në mbledhjen e të dhënave, OSHC-të gjithashtu nxiten që të marrin një rol të rëndësishëm në monitorimin e drejtpërdrejtë të zbatimit të SDG-ve.

Ne nxisim Kuvendin, Qeverinë qendrore dhe lokale si dhe të gjitha institucionet publike që të raportojnë me

transparencë, objektivitet përbushjen e SDG-ve duke krijuar të gjitha hapsirat e mundshme për pjesëmarrje, dialog dhe konsultim me OSHC-të në të gjithë Shqipërinë.

Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile e vlerëson si thelbësore zhvillimin e rolit të sektorit të shoqërisë civile në zbatimin efektiv të SDG-ve si dhe domosdoshmërinë për rritjen e angazhimit, ndikimit dhe efektivitetit të saj në proceset e zhvillimit të vendit.

Në këtë kuadër, Këshilli konfirmon gatishmërinë, angazhimin dhe vullnetin e palëkundur për të ofruar dhe mundësuar asistencën e organizatave të shoqërisë civile përgjatë të gjithë procesit të përbushjes së SDG-ve përmes njohurive dhe eksperiencave sipas fushave që ky Këshill mbulon.

Prezantohet Projekti

"Aksioni Komunitar për Ruajtjen e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri - ACAP"

Vlorë, 6 korrik 2018

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Andi Kananaj së bashku me Përgjegjësin e Sektorit - Zhvillimi i Projekteve, z.

Erion Banushi morën pjesë në eventin e prezantimit të Projektit "Aksioni Komunitar për Ruajtjen e Zonave të Mbrojtura në Shqipëri - ACAP", i cili u organizua nga CELIM – Shqipëri dhe u mbajt pranë Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë.

Ky projekt zhvillohet në partneritet me "Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario – COSV"; National Agency for the Protected Areas – NAPA; Institute for National Conservation in Albania – INCA dhe financohet nga "Agenzia Italiana per la Cooperazione allo Sviluppo".



Takimi II i Komitetit Drejtues të Programit “Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri” – Faza e II, 2017-2020

Tiranë, 6 korrik 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile morën pjesë në takimin e II të Komitetit Drejtues të Programit “Forcimi i Policimit në Komunitet në Shqipëri”, faza e 2-të, Periudha e Zbatimit 2017-2020, i cili u mbajt pranë ambjenteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Ky projekt financohet nga Sida (Swedish International Development Cooperation Agency) dhe implementohet nga FCG Swedish Development AB.

Në këtë takim ishin z. Ardi Veliu – Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit si dhe Kryetar i Komitetit Drejtues të Programit; z. Pontus Forberg - Drejtor i Projektit FCG; z. Ansi Shundi – Drejtues i Ekipit; znj. Linda Gjermani – menaxhere e programit, Ambasada e Suedisë në Tiranë. Gjithashtu pjesëmarrës të tjerë ishin nga ministri dhe institucione të tjera të përfshira (Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë si dhe Shoqata e Bashkive për Autonomi Vendore). Në takim u prezantua Raporti i progresit të periudhës së parë gjashtë mujore të programit, Plani i Punës për periudhën në vijim dhe buxheti përkatës. Gjithashtu u prezantuan edhe aktivitetet që programi ka zhvilluar gjatë kësaj periudhe.

TAKIME KONSULTATIVE ME ORGANIZATA TË SHOQËRISË CIVILE MBI DRAFTIN E UDHËRRËFYESIT TË RISHIKUAR

10, 12, 17 dhe 20 korrik 2018

Në zbatim të rekomandimeve afatshkurtra të Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) ka ndërmarrë rishikimin e dokumentit të Udhërrëfyesit për hartimin e politikës dhe masave për një mjedis mundësues për shoqërinë civile (miratuar me VKM nr.459, datë 27.5.2015).

Për këtë qëllim, AMShC organizoi katër takime konsultative me përfaqësues të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC), përkatësisht në Vlorë 10 korrik, Korçë 12 korrik, Shkodër 17 korrik dhe Tiranë 20 korrik 2018.

Gjithashtu, Kryeministria dhe Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, krijuan mundësinë që shoqëria civile të jepte kontributin e saj mbi dokumentin e rishikuar të Udhërrëfyesit edhe përmes një procesi konsultimi publik online nëpërmjet Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike të hapur nga data 21 qershor 2018 deri më 20 korrik 2018, në linkun e mëposhtëm:
<http://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/73>.

Në konstatimet e përgjithshme rreth Udhërrëfyesit nëpër këto takimet vërehet se ka mjaft interes nga ana e OJF-ve për përmbajtjen e këtij plani pune dhe dokumenti politik siç është Udhërrëfyesi për një Mjedis Mundësues të Shoqërisë Civile.

Gjithashtu, gjatë prezantimit të materialit nga ana e përfaqësuesve të AMShC-së, vihet re se disa prej pjesëmarrësve jo vetëm që janë njohur paraprakisht me përmbajtjen e materialit, por edhe kanë punuar para realizimit të takimit konsultues/informativ mbi komentet e tyre mbi pjesë specifike të materialit, gjë që tregon interes dhe përfshirje nga ana e tyre.

Në përgjithësi, përditësimi i Udhërrëfyesit për një Mjedis Mundësues të Shoqërisë është parë me optimizëm dhe është përgëzuar puna e ekspertëve të BE-së në bashkëpunim me Kryeministrinë, Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) dhe Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC) për materialin gjithëpërfshirës dhe mbi të gjitha për faktin se në këtë material janë përfshirë edhe çështjet e ngritura nga vetë OJF-të nëpër takimet e tyre që i kanë paraprirë këtij rishikimi dhe përditësimi të Udhërrëfyesit 2018 – 2022.

Nga takimet konsultative të organizuara për njohje dhe sygjerime për përditësimet e Udhërrëfyesit ka pasur mjaft sygjerime, por edhe janë evidentuar problematika të ndryshme nga ana e përfaqësuesve të Shoqërisë Civile nëpër këto qytete të përmbledhura si më poshtë:

1. *Mungesa e një bashkëpunimi konstruktiv me bashkitë e qyteteve përsa i përket mundësive të financimit, mbështetjes me zyra që Bashkitë mund të ofrojnë, por edhe mungesës së shkëmbimit të informacionit që j'u intereson edhe OJF-ve që operojnë nëpër qytete të ndryshme.*
2. *Shumë OJF janë të detyruar të paguajnë taksa për Bashkitë e qyteteve ku operojnë të tilla si taksa e gjelbërimit psh. ku OJF-të konsiderohen edhe si biznes i madh duke sjellë edhe vështirësi financiare për disa OJF ku mjaft prej tyre operojnë dhe mbijetojnë në bazë projektesh.*
3. *Një OJF me disa vite eksperience si e tillë, ka ngritur edhe problemin për konkurrencën e padrejtë përsa i takon aksesit në financime të ndryshme që po sjellin krijimi i disa OJF-ve të quajtuara publike të cilat duket se kanë prioritet tek donatorët e ndryshëm.*
4. *Ndonëse çështja e vullnetarizmit në Udhërrëfyesin e përditësuar ka marrë një vend të rëndësishëm, u ngrit në këto takime edhe çështja dhe problemi se çfarë statusi do të kenë vullnetarët dhe sidomos çështja e sigurimeve (kjo çështje ka masat e përcaktuara për zbatim në Udhërrëfyes si dhe sistemin se di to të monitorohet zbatimi i këtyre masave). Në këtë pikë u diskutua edhe mbi mundësitë e skemave të financimeve nga shteti për projektet me tematikë vullnetarizmin (kjo është një masë e përcaktuar qartë në Udhërrëfyes).*
5. *Janë kërkuar nga OJF-të nëpërmjet përfaqësuesve të tyre lehtësira fiskale gjithashtu procedura më të lehta aplikimi për përthithje fondesh. Kërkohet gjithashtu transparencë në shpërndarjen e fondeve sidomos fondeve publike nga pushteti qendror por edhe ai lokal.*
6. *Disa përfaqësues vlerësuan se takimet konsultative duhet të organizohen më shpesh dhe se AMSHC-ja duhet të angazhohet në një rol mbështetës të shoqërisë civile edhe në kuadrin e pranimit të ankimimeve që OJF-të e ndryshme evidentojnë në rastet kur ato konstatojnë shkelje të të drejtave të tyre apo parregullsi në procesin e vlerësimeve për financime të donatorëve të ndryshëm.*
7. *U ngrit si çështje kuptimi dhe përdorimi i konceptit të Filantropisë Kooperative dhe u sugjerua që të trajnohen kryesisht zyrtarët e Bashkive në lidhje me këtë koncept si dhe për mënyrën sesi duhet të koeporojnë me OSHC-të për t'i shërbyer komunitetit, por konstatohet se kjo duhet shoqëruar edhe me legjislacionin përkatës.*
8. *Treguesit e Udhërrëfyesit janë të natyrës aktivitet e jo masa për t'u ndërmarrë, ndaj duhet të ndryshojë profili i tyre e të theksohen si masa konkrete.*
9. *Të shqyrtohet se si do të sigurohet aktivizimi vullnetar nga subjektet për personat fizikë.*
10. *Duket sikur regjistri i OJF-ve dhe databaza janë të njëjta, ndaj të reduktohet një nga këto terma.*
11. *Në lehtësimin fiskal, të përshihet edhe heqja e taksës vendore.*
12. *Të realizohet monitorimi i zbatimit të Udhërrëfyesit nga OJF-të.*



VLORË, 10 korrik 2018
Takim konsultativ



KORÇË, 12 korrik 2018
Takim konsultativ



SHKODËR, 17 korrik 2018

Takim konsultativ



TIRANË, 20 korrik 2018

Takim konsultativ

Qendra ALTRI organizon aktivitetet mbi luftën kundër korrupsionit

Shkodër, 25 korrik 2018



Me mbështetjen financiare të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) nëpërmjet Thirrjes Nr. 11, Qendra ALTRI (Instituti i Studimeve Ligjore dhe Territoriale) në kuadër të projektit “Lufta kundër korrupsionit fillon nga studentët e drejtësisë që zgjedhin integritetin” zhvilloi aktivitetin me temë “Fokus grup me prindër dhe studentë në luftën kundër korrupsionit në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit “Luigj Gurakuqi” – Shkodër.

Ky aktivitet u organizua në ambjentet e Qendrës Kolping – Shkodër dhe synon zhvillimin e diskutimeve dhe përcjelljen e shqetësimeve të studentëve e prindërve dhe eksperiencat e tyre personale në lidhje me fenomenin e korrupsionit dhe mënyrën e tyre të përqasjes.

Nëpërmjet diskutimeve kërkohet të rritet niveli i ndërgjegjësimit të studentëve për pasojat dhe mjetet e luftimit të korrupsionit aktiv dhe pasiv si dhe përcjellja e informacionit për strukturat ekzistuese brenda fakultetit, ku mund të drejtohen për adresimin e rasteve konkrete, por edhe të merret informacioni i nevojshëm për hartimin e vlerësimit.



IP3 implementon projektin “Alpet Shqiptare - Traditë dhe Mite” Theth, 31 gusht 2018

Përfaqësuesi nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në aktivitetin “Alpet Shqiptare - Traditë dhe Mite”.

Ky aktivitet, është organizuar në formën e informimit dhe sensibilizimit mbi traditën, kulturën dhe mitologjinë e alpeve shqiptare, të implementuar nga “Instituti i Politikave Publike dhe Private (IP3)”, projekt i financuar nga AMShC në kuadër të Thirrjes 11.

Të pranishmëve në event, vizitorë të huaj dhe vendas, i'u shpjegua objekti i projektit dhe arsyet e implementimit të tij, rast i cili evidentoi edhe bukuritë e rralla të alpeve shqiptare.

Zona e implementimit të eventit është përcaktuar fshtati Theth i Komunës Administrative Shalë të qytetit të Shkodrës, pranë InfoPoint-it.



“Histori Suksesi” me Emanuela Pepkola Zaimi Tiranë, 12 shtator 2018

Me rastin e 5-vjetorit të themelimit të Fondacionit “Down Syndrome Albania (DSA)”, znj. Emanuela Pepkola Zaimi, themeluese dhe drejtuese e këtij fondacioni ndau me të pranishmit sfidat dhe sukseset e rrugëtimit të saj. Ky aktivitet i titulluar “Histori Suksesi” u zhvillua në ambjentet e “EuropeHouse”, ku morën pjesë përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) dhe përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile.



Konferenca e Parë e Ballkanit Perëndimor, projekti ReLOaD Shkup (Republika e Maqedonisë), 20 – 21 shtator 2018

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile mori pjesë në Konferencën e Parë të Ballkanit Perëndimor, e cila u mbajt në ambjentet e “Holiday Inn Skopje”, në Republikën e Maqedonisë.

Të ftuarit në këtë konferencë janë nga rajoni i Ballkanit Perëndimor për të diskutuar sfidat, mundësitë dhe mësimet e nxjerra në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve lokale dhe organizatave të shoqërisë civile. Fjalën e hapjes e mbajti z. Suhejl Fazliu, Ministër i Vetëqeverisjes Lokale, znj. Liselotte Isaksson, Shefe e Sektorit - Shoqëria Civile dhe Përfshirja Sociale, Bashkëpunimi dhe Programet Rajonale të Ballkanit Perëndimor, DG NEAR, Komisioni Evropian dhe znj. Narine Sahakyan, Përfaqësuesë e Përhershme e UNDP-së.

Konferenca është organizuar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor dhe bashkë-organizuar nga UNDP në Shkup. Mbështetur nga Bashkimi Evropian, ajo synon të forcojë partneritetet ndërmjet qeverive lokale dhe OShC-ve në Ballkanin Perëndimor me një fokus në financimin transparent të OShC-ve në të gjithë rajonin.

Dëgjese me Organizatat e Shoqërisë Civile të Shqipërisë në Politika e Rinisë dhe Pjesëmarrja e të Rinjve Tiranë, 25 shtator 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në dëgjesën me Organizatat e Shoqërisë Civile të Shqipërisë në politika të rinisë dhe pjesëmarrja e të rinjve, e cila u organizua nga Komiteti Ekonomik dhe Social Evropian dhe u mbajt në ambjentet e XHEKO Imperial Hotel. Të ftuarit në këtë forum ishin të gjithë përfaqësuesit e OJF-ve rinore jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga rajoni i Ballkanit Perëndimor për të diskutuar sfidat e të rinjve si dhe pjesëmarrja në vendimarrje.

“Gruaja Intelektuale Shkodrane” zhvilloi forum civil në Postribë Shkodër, 26 shtator 2018



Në kuadër të projektit “Së bashku për mjedisin”, mbështetur nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), shoqata “Gruaja Intelektuale Shkodrane” (GISH) zhvilloi forumin civil në Postribë, me pjesëmarrjen e gjerë të të rinjve, banoreve dhe punonjësve të kësaj njësie administrative. U prezantuan detyrat ligjore që ka Bashkia Shkodër në ofrimin e shërbimeve mjedisore, të përfshira në Broshurën Informuese. Pjesëmarrësit u treguan tepër aktiv dhe diskutuan rreth problematikave mjedisore në zonën e tyre. Ndër të tjera, ata evidentuan disa pika me përqendrim të lartë të mbetjeve urbane, të cilat shkaktojnë ndotje të mjedisit dhe rrezikojnë shëndetin e banoreve.



**Organizata “New Vision” prezanton
përmbledhjen e punës 6-mujore
për projektin “Kreativiteti Krijon Ndyshim”**

Tiranë, 19 tetor 2018

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në prezantimin e përmbledhjes së punës 6-mujore të Organizatës “New Vision” lidhur me implementimin e projektit “Kreativiteti Krijon Ndyshim”, aktivitet i cili u mbajt në ambjentet e Qendrës Rinore të Tiranës.

Ky projekt mbështetet financiarisht në kuadër të Thirrjes Nr. 11 të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC).

Organizatorët e aktivitetit shprehen krenarinë dhe mirënjohjen kundrejt të gjithë vullnetarëve që i janë përkushtuar krijimeve si dhe falenderime përfaqësuesve të AMShC-së për mbështetjen.



**Takim pune nga Grupi i Punës
me përfaqësues të Institucioneve,
në luftën kundër korrupsionit**

Tiranë, 19 tetor 2018

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në takimin e personave përgjegjës të Institucioneve përgjegjëse në luftën kundër korrupsionit, si pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale, të organizuar nga Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave pranë Ministrisë së Drejtësisë.

Qëllimi i takimit fokusohet në qartësimin e mënyrës së raportimit, inspektimit dhe para-shikimit të veprimeve që mund të ndikojnë në përmirësimin e procesit të monitorimit të luftës kundër korrupsionit.

***Takim i Grupit Ndërinstitucional të Punës në funksion të
raportimit pranë Bashkimit Evropian***

Tiranë, 22 tetor 2018

Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), i nominuar si personi përgjegjës për raportim, mori pjesë në takimin e anëtarëve të Grupit Ndërinstitucional të Punës në funksion të raportimit pranë Bashkimit Evropian. Ky raportim përmban informacione lidhur me Kapitullin 23 me procesin screening të integritetit evropian. Për të mbështetur rëndësinë e këtij procesi, takimi u drejtua nga koordinatorët e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Drejtësisë, të përfaqësuar nga ministrat z. Ditmir Bushati dhe znj. Etilda Gjonit. Në takim u vendos lidhur me përcaktimin e një plani takimesh paraprake në funksion të punës së Grupit dhe më tej u diskutua lidhur me përgjegjësitë që duhet të përvetësojë çdo Institucion i përfshirë në këtë grup pune.



**“Gruaja Intelektuale Shkodrane (GISH)” : Forume civile mbi mjedisin
Shkodër, 25 tetor 2018**

Shoqata “Gruaja Intelektuale Shkodrane (GISH)” në zbatim të projektit “Së bashku për mjedisin”, i cili mbështetet në kuadër të Thirrjes Nr. 11 të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) vijon me organizimin e forumeve civile në qytetin e Shkodrës. Pjesëmarrësit u treguan të interesuar për të njohur kompetencat e Bashkisë Shkodër në ofrimin e shërbimeve mjedisore. Gjatë diskutimeve, por edhe në grupet e punës u evidentuan problematikat e ndryshme mjedisore dhe pati edhe shumë sugjerime. Mbetjet urbane, mungesa e hapësirave publike të gjelbëruara dhe mirëmbajtjes së tyre ishin disa nga shqetësimet e ngritura në këtë takim.

Takim përmbyllës i projektit “Qytetari Aktive në Qeverisjen e Bashkisë Krujë”

Krujë, 30 tetor 2018



Qendra Instituti i Bashkëpunimit Rajonal për Integrim (IBRI) organizoi takimin përmbyllës të projektit me titull “Qytetari Aktive në Qeverisjen e Bashkisë Krujë”, projekt i cili u mbështet financiarisht në kuadër të Thirrjes Nr. 11 të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC).

Ky projekt synon fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare në qeverisjen e Bashkisë së qytetit të Krujës përmes informimit të tyre lidhur me të drejtat qytetare dhe ligjore.

Qendra ALTRI organizon “Ditë e Hapur Anti-Korrupsion”

Shkodër, 30 tetor 2018



Qendra ALTRI zhvilloi aktivitetin “Ditë e Hapur Anti-Korrupsion” me studentët e Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin “Luigj Gurakuqi” - Shkodër, i cili u mbajt pranë ambjenteve të Bibliotekës së Universitetit të Shkodrës. Ky aktivitet organizohet si pjesë e projektit “Lufta kundër korrupsionit fillon me studentët e drejtësisë që zgjedhin integritetin”, projekt i cili mbështetet financiarisht në kuadër të Thirrjes Nr. 11 të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC). Studentët u njohën me ecurinë e projektit, ndërkohë që pati opinione dhe debate të frytshme prej tyre për mjetet e luftimit të këtij fenomeni. Në fund u themelua dhe Klubi i Integritetit me 26 studentë, që tashmë do veprojnë si një strukturë studentore në luftën kundër korrupsionit.

Konferenca “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”

Tiranë, 2 nëntor 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në Konferencën “Ekstremizmi i dhunshëm në Shqipëri”, e cila u organizua nga IDM Albania në ambjentet e “Hotel Tirana International”, në kuadër të Projektit “Përmirësimi i kapaciteteve në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm” të mbështetur financiarisht nga Zyra e Marrëdhënieve me Publikun e Ambasadës së ShBA në Tiranë.

Tre vjet pas vlerësimit të parë të fenomenit të Radikalizmit fetar (#religiousradicalism) dhe ekstremizmit të dhunshëm (#violentextremism) në Shqipëri, IDM Albania lançoi studimin më të fundit që bën një analizë të situatës dhe një vlerësim të gjithanshëm të nxitësve dhe faktorëve të tjerë që çojnë apo mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm në nivel kombëtar. Qëllimi i konferencës dhe studimit është informimi i vendim-marrësve dhe proceseve politikëbërëse, masave institucionale të aktorëve shtetërorë, si edhe veprimeve të aktorëve jo-shtetërorë (shoqëria civile, komunitetet fetare, media etj.) në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në vend, bazuar në Strategjinë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm.



Forumi 4 Konsultativ kundër korrupsionit - Konflikti i Interesave Tiranë, 7 nëntor 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në Forumin e 4-rt Konsultativ për tematikën e luftës kundër korrupsionit, të organizuar nga Ministria e Drejtësisë, njëkohësisht Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit, me mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit të financuar nga BE “Mbështetje për Formulimin, Koordinimin dhe Zbatimin e Politikave Anti-Korrupsion”, i cili u mbajt në ambjentet e Ministrisë së Drejtësisë. Fokusi kryesor i këtij forumi është tema e Konfliktit të Interesit të zyrtarëve të lartë të administratës publike, baza ligjore, mënyrat e trajtimit dhe zgjidhja e tij.

Me prezencën dhe ligjërimin e z. Drago Kos, Kryetar i Grupit të Punës për Mitmarrjen pranë Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), paneli i ftuar, vijoi me diskutimet dhe ofrimin e konsultimeve në funksion të parandalimit të konfliktit të interesit.

Sesion Informimi mbi IPA II Cross-Border Mali i Zi - Shqipëri Podgorica (Mali i Zi), 9 nëntor 2018



Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) morën pjesë në sesionin informues, i cili u zhvillua në kuadër të “IPA II Cross-Border – Program Bashkëpunimi Mali i Zi – Shqipëri 2014-2020”. Gjatë sesionit të parë, pjesëmarrësit u informuan mbi Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi - Shqipëri 2014-2020, parimet e partneritetit ndërkufitar dhe përmbajtjen e përgjithshme të paketës së aplikimit; ndërsa gjatë pjesës së dytë, ata morën pjesë në workshop me tematikat:

1. *Mbrojtja e mjedisit, promovimi i përshtatjes dhe zbutjes së ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rrezikut*
2. *Promovimi i punësimit, mobilitetit të punës dhe përfshirjes sociale dhe kulturore në të gjithë kufirin*

Ky aktivitet u mundëson të gjithë partnerëve potencialë të projektit që të takohen me njëri-tjetrin, të ndajnë dhe diskutojnë për idetë e tyre të projektit.

Trupat Europiane të Solidaritetit (European Solidarity Corps) – “Aktivitete për ngritjen e partneritetit” Lubjana (Sllovenia), 2 – 7 dhjetor 2018

Në Lubjanë u zhvillua aktiviteti i parë në nivel evropian, për të mbështetur organizatat në takime dhe rrjetëzime brenda programit të Njesisë Evropiane të Solidaritetit. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) përfaqësohet në këtë aktivitet nga z. Andi Kananaj – Drejtor Ekzekutiv si dhe z. Erion Banushi – Përgjegjës i Sektorit - Zhvillimi i Projekteve. Aktiviteti i krijoi pjesëmarrësve hapësirë për të njohur punët dhe interesat e njëri – tjetrit, për të eksploruar idetë e mundshme për projekte të përbashkëta dhe për të ngritur partneritete cilësore. Aktiviteti mbledhi së bashku 67



pjesëmarrës nga 19 vende të ndryshme dhe grupe interesi, nga të sapoardhurit në program, tek ata, të cilët tashmë janë aktivë në projektet e mobilitetit, por dëshirojnë të punojnë më shumë në këtë përfshirje.

Elementët e programit:

- *Prezantimi i Trupave Europiane të Solidaritetit (European Solidarity Corps)*
- *Ngritja e kapaciteteve për përfshirjen*
- *Aktivitete për ngritjen e partneritetit*
- *Hapësirë për krijimet e projektit dhe krijimin e drafteve*
- *Hapat e Follow Up (krijimi i një rrjeti të organizatave gjithëpërfshirëse, trajnim për organizatat)*



Organizatrat patën mundësi të formonin grupe të veçanta interesi sipas projekteve për të cilat janë të interesuar - goftë projekte vullnetare, vende pune dhe trajnime. Ky event u organizua nga MOVIT, Agjencia Kombëtare e Trupave Europiane të Solidaritetit (European Solidarity Corps) dhe Erasmus+: Programi “Youth in action” në bashkëpunim me 15 Agjencia Kombëtare të Programit European Solidarity Corps: Zvicër; Portugali; Kroaci; Belgjikë-Flanders; Belgjikë-Franceze; Gjermani; Lituani; Estoni; Bullgari; Qipro; Danimarkë; Suedi; Poloni; Mbretëri e Bashkuar; Finlandë and Salto South East Europe.

Partnerët Shqipëri zhvilloi ankandin e parë LIVE “Rathë Dhurues”

Tiranë, 4 dhjetor 2018

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) mori pjesë në eventin “Rathë Dhurues 2018”, i cili u organizua nga “Partnerët Shqipëri” për promovimin e filantropisë dhe në mbështetje të iniciativave të cilat do të transformojnë jetën dhe do të sjellin ndryshime të qëndrueshme sociale për komunitete në nevojë.



Rathë Dhurues (Giving Circle) është një event që zhvillohet në 16 vende të botës, duke mbledhur së bashku individë të cilët përmes shembullit të tyre personal dhurojnë për kauza sociale duke treguar një ndjenjë të lartë qytetare dhe solidariteti njerëzor.

Rathë Dhurues 2018 i organizuar për herë të parë në Shqipëri, mbledhi së bashku përfaqësues të lartë të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, institucioneve diplomatike, shoqërisë civile, medias, artit etj., të cilët ofruan mbështetje financiare dhe materiale për tre iniciativa:

1. *Një kopsht për fëmijët e fshatit Bllçe – Peshkopi, e ndërmarrë nga Vizion OJF*
2. *Adopto një terapi – Tiranë, një iniciativë e Fondacionit Down Syndrome Albania*
3. *Edukimi dhe integrimi i fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian përmes sportit – Shkodër, nga Shoqata për të Drejtat e Komunitetit Egjiptian*

Shuma totale e mbledhur prej 1,681,874 Lekë kaloi objektivin e vendosur, duke konfirmuar edhe njëherë ndjeshmërinë qytetare ndaj grupeve në nevojë.

Falë ndjeshmërisë dhe vëmendjes së lartë mediatike që mori event, iniciativat vijojnë të sigurojnë mbështetje financiare edhe nga individë që nuk mundën të bëhen pjesë e tij.

Eventi Rathë Dhurues 2018 u mbështet nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri si pjesë e aktiviteteve të projektit “EMBRACE – Modele Sipërmarrjeje që ndërtojnë Marrëdhënie dhe Ekonomi Krijuese”, Balkan Trust for Democracy – një projekt i German Marshall Fund of the United States, Frederick Mulder Foundation, The Funding Network, Credins Invest, Telekom Albania, dhe Iceberg Communications.



TAKIME KONSULTATIVE me Organizata të Shoqërisë Civile

Prezantim, Informim dhe Konsultim mbi Programin Anti-Korrupsion
të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC)

Nëntor – Dhjetor 2018

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë Ndërsëktoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC) organizoi takime në disa qytete, me aktorë të shoqërisë civile për Prezantimin dhe Konsultimin mbi Programin Anti-Korrupsion të AMShC-së.



PESHKOPI, 13 nëntor 2018



KORÇË, 16 nëntor 2018



POGRADEC, 20 nëntor 2018



VLORË, 22 nëntor 2018



PËRMET, 27 nëntor 2018



KUKËS, 4 dhjetor 2018



BERAT, 6 dhjetor 2018



TIRANË, 7 dhjetor 2018

Prezantohet Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës

Tiranë, 14 dhjetor 2018



Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMShC), z. Andi Kananaj mori pjesë në aktivitetin e organizuar nga Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, ku u prezantua Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës, i cili është një nga tre strukturat kryesore të cilat do të aplikojnë politikat e reja e shtetërore për Diasporën shqiptare.

Në fjalën e tij përshëndetëse ministri tha se Fondi i Zhvillimit të Diasporës ka garancitë e nevojshme juridike të një institucioni publik jobuxhetor i cili kërkon të hapë një faqe të re marrëdhëniesh me donatorët e interesuar.

Gjithashtu ai theksoi se krijimi i këtij fondi shpreh faktin se migracioni shqiptar po del nga faza e stacionit të pas viteve 90-të në Perëndim. E pranishme në këtë prezantim ishte edhe Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, znj. Sonila Qato, e cila në fjalën e saj tha se institucioni që ajo drejton është i hapur për bashkëpunimin dhe krijimin e politikave të cilat do të mundësonin një angazhim më të madh të Diasporës shqiptare në vendin tonë.

Drejtoresha Ekzekutive e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për Diasporën, znj. Soana Jaupllari bëri një prezantim të përgjithshëm të misionit të këtij institucioni, duke u ndalur tek projektet konkrete që ky fond do të realizojë për të mbështetur anëtarët e Diasporës për të dhënë kontributin e tyre në çështjet arsimore, kulturore e shëndetësore.